

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7610 E shtunë 4 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje
në 'Deutsche Welle'
Po të vijë në vjeshtë për vizitë në Gjermani, Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan, do të ketë shumë probleme për të diskutuar me mikpritësit. Sfidat vërtet...
Vijon në faqen 22

Nga KERSTEN KNIPP
Turqia dhe Evropa, në kërkim të përbashkësive


Opinion
i Ditës
Në përvjetorin e 75-të të Kuvendit të Mukjes, sapo botova, pas një hulumtimi dhe studimi të gjatë të arkivave shqiptare dhe të huaja, librin "Marrëveshja..."
Vijon në faqet 20-21

Nga DR. URAN BUTKA
Marrëveshja historike e Mukjes



Presidenti: Teatër të ri apo restaurim? Të gjitha bëhen

Kthimi i dy ligjeve, Meta: S'mund të rri indiferent, bazohem në Kushtetutë

"E papranueshme të thuhet më mirë pa gjykata se me të korruptuara"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ishte dje në qytetin e Shkodrës në kuadër të nismës për dhurimin e gjakut, ku dha një intervistë ekskluzive për televizionin "TV1 Channel". Nuk kisha si mos të shfrytëzoja praninë tuaj në studio për të parë dhe pak zhvillimet kryesore dhe keni qenë në qendër të vëmendjes si Institucion për shkak...

Në faqet 2-3

JA DOKUMENTET E PLOTA QE DUHET TE PARAQESIN FITUESIT E FAZES SE PARE

KREDIA E BUTE, BASHKIA: AFATI I FUNDIT QE KENI

"Kujdes, nuk ka fazë tjetër pranimi! Po nuk ishit në rregull me dokumentet e afatet, humbni mundësinë për të marrë shtëpi me interes të ulët"



(Në foto) Banesa sociale

VENDIMI I QEVERISE
Hapen 200 vende të reja në administratë, ja dikasteret ku mund të konkurreni
Në faqen 6

VETEVRASJA
Gruaja e gjyqtarit vuante nga një sëmundje e rëndë, si ndodhi ngjarja
Në faqen 8

STRUKTURA E RE
Zbardhet VKM-ja, krijohet Taks-Forcë për kontrollin e sërvisëve, ç'do ndodhë
Në faqen 5

VETEDOREZOHEN VRASESIT
Vrasja e 23-vjeçarit në Itali, babai: Viktorin e qëlluan në sy të vëllait, shteti të më sjellë trupin
Në faqen 9

TRADITA VAZHDON



Festa e Birrës ju fton 'Check in Korça', sipari më 8 gusht, 5 net argëtim e surpriza
Në faqen 6




Dafina Zeqiri provokon duke dalë nudo. Kush është Luana në të vërtetë?

Adelina Berisha lidhet me djalin e Lefter Kokës

Pushimet e ëmbla të këngëtares dhe Arbrit në jug të vendit

Nga EGLA XHEMALI
Ajo është një ndër këngëtares më popullore, ndërsa ai ndër beqarët më të kërkuar të vendit tonë. Mesa duket, një tjetër histori dashurie ka lindur në radhët e VIP-ave, që deri më sot është ruajtur me fanatizëm dhe larg



syrit të publikut. Po flasim për këngëtares kosovare, Adelina Berisha dhe djalin e deputetit të Durrësit, Lefter Koka, Arbri. "Bluetooth" ka mundur të mësojë se dyshja është në një lidhje dashurie prej pak kohësh. Arbri dhe Adelina janë...

Suplement

Në faqen 9

KREU I SHTETIT

INTERVISTA

Presidenti: E papranueshme të thuhet më mirë pa gjykata se me të korruptuara

Kthimi i dy ligjeve, Meta: Smund të rri indiferent, bazohem në Kushtetutë

"Teatër të ri apo restaurim? Të gjitha bëhen, por jo me ligj preferencial"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ishte dje në qytetin e Shkodrës në kuadër të nismës për dhurimin e gjakut, ku dha një intervistë ekskluzive për televizionin "TV1 Channel".

Nuk kisha si mos të shfrytëzoja praninë tuaj në studio për të parë dhe pak zhvillimet kryesore dhe keni qenë në qendër të vëmendjes si Institucion për shkak se njëri pas tjetrit keni kthyer dy ligje në Kuvendin e Shqipërisë: së pari "Për Teatrin" dhe më pas "Mbi tatimit mbi të ardhurat", që shkaktuan shumë debate. A ka pasur ndikim edhe politika, zhurma e madhe që u krijua në këtë kthim të këtyre dy ligjeve?

Po bëhet saktësisht një vit nga fillimi i detyrës sime si president, nga momenti i betimit, dhe unë theksoj që numri i ligjeve të kthyera është vetëm tre. Një për "Tarifat gjyqësore", për të cilën u rrekta nga Kuvendi dhe që ishin në interes të qytetarëve, pasi tarifat rriteshin shumë, ishin mjaft të papërbalueshme dhe rrezikonin që qytetarët për shkak të tarifave të larta të mos ndiqnin të drejtat e tyre nëpër procese gjyqësore të rregullta. Natyrisht, kemi edhe dy aktet e fundit, që shkurtimisht quhen "Për Teatrin" dhe "Lojërat e Fatit". Në arsyetimet e bëra, ne bazohemi tërësisht në Kushtetutë, në ligj, në marrëshjet ndërkombëtare, në interesin kombëtar dhe në interesin e publikut. Kështu që Kuvendi ka të drejtën e tij t'i rishqyrtojë, të reflektojë ose jo, në varësi të gjykimit të tij përfundimtar. Pa dyshim që institucioni i Presidentit nuk mund të qëndrojë indiferent apo të kalojë në heshtje çështje, të cilat i konsideron që jo vetëm krijojnë probleme në raport me parimet kushtetuese, me objektivat që kemi në Kushtetutë përsa i takon shtetit, shoqërisë sonë, por njëkohësisht edhe me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, ku vendi ynë është palë, apo që mund të krijojnë precedentë shqetësues në të ardhmen, sidomos përsa i takon aleancës midis pushteteve apo cenimit të ekonomisë së pushtetit vendor, sepse do të heqim dorë nga ligësitë... demokratike dhe të funksionimit demokratik të shtetit dhe të shoqërisë.

Ju personalisht jeni për ta prishur Teatrin, në gjykimin tuaj, sepse ka një ndarje edhe të vetë artistëve, edhe të klasës politike.

Unë mendoj se ruajtja e gjithçkaje që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore, historike, muzeale është një detyrë e të gjithëve. Për fat të keq në të kaluarën nuk kemi treguar shumë të kujdesshëm ndaj ruajtjes së këtyre vlerave dhe kemi dëmtuar shumë prej tyre. Po kështu, historia e shtetit tonë nuk është shumë e vjetër dhe kemi nevojë që të jemi shumë e më të vëmendshëm dhe të ndërgjegjshëm për çdo vlerë



Presidenti Ilir Meta

kulturore, historike e muzeale që ne kemi nga e kaluara. Sot lexova dokumentet e një historiani shqiptar se gjatë Luftës së Dytë Botërore për çlirimin e Tiranës, edhe pse Mehmet Shehu kishte kërkuar, për të shpejtuar largimin e nazistëve nga kryeqyteti, të bombardohej qendra e Tiranës, anglezët nuk kishin pranuar të jepnin një urdhrë të tillë, pra që avionët e tyre të bombardonin qendrën e Tiranës, për arsye se nuk kishin dashur të dëmtohej kjo pjesë, e cila mbart vlera të rëndësishme për kryeqytetin. Në këtë drejtim, unë besoj se kur ekzistojn vullneti i mirë, absolutisht që mundësi është edhe për të restauruar dhe për të mirëmbajtur Teatrin ekzistues apo kompleksin ekzistues, edhe për të ndërtuar një Teatër të ri, që pa dyshim Tiranë si kryeqytet, e cila është shtuar disa herë në numër në këto tri dekada ka nevojë për Teatër të ri, ka nevojë për qendra të reja të zhvillimit të kulturës, të artit. Të gjitha këto mund të ndodhin absolutisht duke respektuar Kushtetutën dhe legjislacionin aktual në fuqi në vendin tonë. Pra, nuk ka nevojë për një ligj të veçantë, për një ligj preferencial, për një precedent të themi, i cili na nxjerr nga shinat e funksionimit demokratik, kushtetues, ligjor të shtetit dhe shoqërisë sonë.

Zoti President, u mbyll dhe ky sesion parlamentar dhe sigurisht ka pasur protesta nga ana e opozitës, debate, bilokim të foltores së Kuvendit. Në të njëjtën

kohë u shty edhe procesi i celjes së negociatave. Si janë lexuar nga Institucioni i Presidentit të gjitha këto zhvillime të brendshme, por edhe të jashtme dhe përcillet me shqetësim nga ana juaj kjo frymë, që deri diku nuk u shërben proceseve të vendit?

Pa diskutim që kjo është një frymë që nuk u shërben proceseve të vendit dhe nëse do të vazhdohej në këtë mënyrë, absolutisht që nuk do të ketë çelje të negociatave në qershorin e ardhshëm. Përkundrazi do të ketë përsëri përpjekje për të gjetur faktorë, apo për të shpikur faktorë për këtë çështje. Unë e them shpesh që në të kaluarën kemi vuajtur shumë si popull nga një izolim idiot, se s'mund ta quajmë ndryshe. Të kishim qenë të izoluar por "më butë" si disa vende të tjera të ish-Europës Qendrore dhe Lindore, por izolimi ekstrem prodhoi dhe pasoja, të cilat nuk mund t'i kuptojë dikush që nuk e ka jetuar atë periudhë dhe nuk arrijnë t'i kuptojnë apo perceptojnë as femijet tanë sot. Për fat të keq, pas 28 viteve përsëri kemi një konflikt të pajustificuar dhe kemi një pasion për konflikt ku dialogu duhet të mbizotërojë, sidomos për çështje me rëndësi kombëtare, sikurse është çështja e integritimit evropian, sepse kjo është një platformë dhe një qëllim i gjithë forcave politike në vend dhe një aspiratë e të gjithë qytetarëve shqiptarë. Kështu që, në këtë drejtim duhet të bëhen përpjekje shumë të mëdha për të rivendosur dialogun. Duhet të bëhen

Dhurimi i gjakut

Në kuadër të nismës së ndërmarrë, "Aleanca për Dhurimin e Gjakut", Presidenti i Republikës, Ilir Meta ishte dje në qytetin e Shkodrës. Presidenti së bashku me kryebashkiaken e Shkodrës, Voltana Ademi ndoqën nga afër seancën e dhurimit të gjakut nga punonjësit administratës dhe qytetarë. Meta tha se shpreson që të rinjtë të bëhen edhe promovuesit kryesorë të kësaj aleance dhe të këtij solidariteti mbarëshoqëror të dhurimit të gjakut.

për gjithë ecurinë e sundimit të ligjit dhe për gjithë suksesin, qoftë në luftë kundër krimit të organizuar, qoftë në luftën kundër korrupsionit dhe jo vetëm kaq. Këto janë dy fenomene që luftohen për një arsye tjetër: për të garantuar një ambient ekonomik e social shumë më të favorshëm për qytetarët tanë, për biznesin vendas, për investitorët e huaj, në mënyrë që këtu të jetë një ambient i besueshëm dhe të shtohen investimet dhe njëkohësisht edhe të rritet besimi dhe shpresa e qytetarëve tanë sidomos e të rinjve, se mund ta garantojnë të ardhmen e tyre në vendin tonë. Në këtë drejtim, unë besoj se duhet një reflektim i thellë, në këto kohë pak të trazuar në nivel global, evropian, ndërkombëtar. Ne na duhet që të forcojmë më shumë përgjegjshmërinë dhe unitetin e brendshëm, ku ptohet për ato çështje që janë jetike, për të forcur qëndrueshmërinë e një shteti dhe të një shoqërie pa cenuar funksionimin e demokracisë, aq më tepër të diferencave të ndryshme politike, programore, ideore. Mendoj që hapësira për të shpalosur diferencat është shumë e madhe, sepse fushat janë shumë të mëdha, por janë disa çështje kyçe, të cilat janë të një rëndësie jetike dhe afatgjatë për qëndrueshmërinë e shtetit dhe për qëndrueshmërinë e shoqërisë dhe për të ruajtur kohezionin e saj social ku duhet bashkëpunim.

Pra, e shihni të vështirë realizimin e atyre pikave shtesë?

Jo, unë nuk shikoj asgjë të vështirë nëse ka vullnet për përmirësimin e tyre dhe bashkëpunohet në mënyrë të qëndrueshme për përmirësimin e atyre shteteve dhe standardeve që kërkohen nga vendet e BE-së.

U cilësuva "një shuplakë e fortë" raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit. U fol shumë për PPP-të, për krimin e organizuar. U fol gjithashtu edhe për çështjen që ka të bëjë me korrupsionin, që ende mbetet në nivele të larta në Shqipëri. Nga ana juaj si Institucioni i Presidentit të Republikës, besoj se e keni analizuar këtë raport. Keni ndonjë koment?

Pa dashur të hyj në komente më të drejtëpërdrejta që u takon aktorëve të ndryshëm politikë apo analistëve dhe publicistëve, them që duhet një përpjekje shumë serioze dhe e qëndrueshme edhe e mazhorancës, edhe e opozitës për të garantuar besueshmërinë e reformës në drejtësi, sepse kjo është kyçe



Presidenti Meta në Bashkinë Shkodër, me "Aleancën për Dhurimin e Gjakut"

te reja të drejtësisë. Askush nuk e ka menduar kur ka nisur reforma që do të ndodhë kjo e dytë, për arsye se janë bërë mjaft përcaktimet dhe në Kushtetutë, në mënyrë mjaft konkrete, të cilat parashikojnë që këto institucione duhet të ishin krijuar me kohë, që që nuk ka ndodhur. Kjo e bën edhe më të domosdoshme rivendosjen e dialogut mazhorancë-opozitë, në mënyrë që kjo anomali apo një kolaps i mundshëm i funksionimit të sistemit gjyqësor të evitohet dhe të krijohet mundësia që jo vetëm procesi i vetingut të vazhdojë dhe të jetë edhe më i shpejtë dhe të mbështetet edhe me shumë administrata që kryen vetingut qoftë me staf apo me fonde, me mbështetje buxhetore. Po kështu të bëhen të gjitha ato ndryshime që janë të domosdoshme për t'u reflektuar, që i hapin rrugën krijimit të besueshëm, me integritet të gjitha institucioneve të reja të drejtësisë. Nuk mund t'i vëmë fajin vetingut për këtë situatë, por mendoj që fajit është i mungesës së dëshirës për të parë problemet reale, kushtetuese dhe ligjore, të cilat duhet të rishikohen për të tejkaluar këtë situatë dhe për të krijuar institucionet e reja. Nuk mund të themi dhe është e papranueshme të themi që më mirë pa gjykata fare se sa me gjykata të korruptuara. Absolutisht. Njerëzit nuk e kanë përklaruar reformën për këtë çështje, që të ngelen pa gjykata sepse janë mbi 30 mijë dosje që presin nëpër gjykata dhe këto janë probleme që kanë qytetarët me shtetin, me bashkinë, me njëri-tjetrin dhe kërkohet drejtësi, kërkohet zgjidhje. Zgjidhja është edhe vetingut, edhe lufta kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë dhe njëkohësisht edhe krijimi i institucioneve të reja, të besueshme, të pavarura të cilat do të japin atë drejtësi që qytetarët presin.

Meqenëse në politikë keni qenë shpesh mbi palët dhe i keni ftuar në tryezë, me cilësinë e Presidentit a jeni i gatshëm në rast se nuk ka një dakordësi mes gjyesh politikë mes mazhorancës dhe

Vetëngut u duk se shkaktoi një tërmet në sistemin e drejtësisë. Shumë prokurorë e gjyqtarë nuk po arrijnë të arsyetojnë pasurinë e tyre, kanë probleme përsa u përket dosjeve të gjykuara. Deri diku po shkohet drejt një kolapsi, nëse mund ta quajmë kështu, me gjithë këto largime në radhët e drejtësisë. Si e keni parë ecurinë e këtij procesi? Po ju pyes se si e keni parë, se opozita ju pak e ka sulmuar kohët e fundit, ndërkohë që nga ana tjetër mazhoranca po e quan si ai filtri i duhur, pasi për 28 vite drejtësi ka pasur probleme të theksuara.

Janë dy çështje të ndryshme. Funksioni i vetingut dhe njëkohësisht paralizimi, mosfunksionimi apo mosndërtimi i institucioneve



← opozitës? Pra, t'i ftoni, pse jo, për hir të këtyre reformave?

Si President, përsa i takon reformës në drejtësi, unë do t'i përbush të gjitha detyrimet e mia në mënyrë transparente, për aq sa Presidenti i Republikës ka detyrime në raport me Kushtetutën e vendit që është sot në fuqi. Unë kam dhënë mesazhe herë pas here përsa i takon reformës në drejtësi, duke evituar situatat konfliktuale, polarizuese, për aq sa i takon, duke evituar shtimin e problemeve, të cilat janë evidentuar dhe janë shtuar, janë politizuar më shumë se sa duhet. Natyrisht që unë i takon të dyja palëve të reflektojnë dhe të kuptojnë se shteti i drejtësisë nuk mund të politizohet në mënyrë ekstreme për çfarëdolloj arsyeje dhe duhet sa më shpejt që përmes një dialogu të zgjidhet të gjitha ato ngërçet ato vështirësi, të cilat kanë krijuar një paralizë në shumicën institucionale në institucionet e drejtësisë për momentin.

Ndoshta disa media të caktuara mund t'ju kenë paragjykuar në cilësinë e kreut të shtetit, sa ka ndikuar zonja Kryemadhi në vendimet që merrni apo në interpretimet e situatave politike? Realisht komunikoni për këto zhvillime apo qaderim në cilësinë e një drejtuesi të një force opozitare?

Tani duhet të jeni të sigurt që në vendimet që marr si President i Republikës, unë ndikohem vetëm nga Kushtetuta, nga ligji, nga interesi kombëtar, nga interesi publik dhe nga askush tjetër për çfarëdolloj arsyeje. Së dyti, kushdo që nuk ballafaqohet dot me ato argumente që Institucioni i Presidentit mund të japë në një moment të caktuar, që nuk i interesojnë, për çdo gjë arsyeje që nuk po i paragjykoj, sigurisht që ka të drejtë të gjëjë alibitë e tij për të justifikuar këtë pozicion. Unë i ftoj të gjithë që për të gjykuar një akt apo një veprim të Presidentit, të gjithë thjesht t'i referohen faqes zyrtare, t'u referohen argumenteve, të lexojnë Kushtetutën, të lexojnë projektligjin, të lexojnë relacionin. Historitë e tjera pastaj më duken pa kuptim, ashtu sikurse zonja Kryemadhi ka të drejtën e saj që për çdo problem të kaluar të ma vërë mua fajin, është çështje e saj.

Megjenë mbërritën në fund, e lashë jo më kot këtë pyetje, ishit në Plavë e Guçiku kenë takuar bashkëdhjetarët tanë, të cilët më së shumti vijnë nga jashtë. Pyetja ime lidhet me shqiptarët në të gjitha trojet ku jetojnë. Kanë kërkuar ndoshta një prani më të madhe të shtetit shqiptar, ndoshta ju në cilësinë e Presidentit, së fundmi me dekretimin e ligjit për zyrërizimin e mesimit të gjuhës shqipe në diasporë, keni dhënë një mesazh që lu shërben atyre, por edhe klasës politike?

Së pari, jam shumë i lumtur që isha në Plavë e në Guçik. Dhe që isha në ditën e ditës, sepse kam qenë para 15 vitesh kur kam qenë ministër i Jashtëm. Kam qenë natën, ka qenë janar atëherë, por kam qenë në orën 2 të mëngjesit dhe jam këtu në orën 5 të mëngjesit, sepse kisha takime në Podgoricë. Ajo që kam parë ka qenë mahnitëse. Vërtet një bukurri përallorë, pak a shumë si bukuritë e Valbonës në Theth apo Lëpushë, Vermosh. Një diçka vërtet e jashtëzakonshme. Ajo që më ka mbetur më shumë në mendje përveç bukurisë së jashtëzakonshme, është atdeshdashuria e pamasë, e pakufishme e diasporës, sidomos e shqiptarëve të Malit të Zi, të cilët jetojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Europë dhe vende të tjera, por jo vetëm, duke menduar për vendin. Ai për kushtimin i tyre, që jo vetëm në fund të korrikut deri në mes të gushtit që e vinë të gjithë me familjet, me nipë, me mbesa, me çdo gjë, për t'u kujdesur për shtëpitë e tyre, për t'u kujdesur për varret e të parëve të tyre, për të marrë pjesë në këto veprimtari shumë interesante, që ruajnë traditën, kanë vlerë të gjithë këta tjetër. Vërtet që është një detyrim edhe më i madh i shtetit tonë për t'u kujdesur për shqiptarët kudo edhe më shumë. Për fat të mirë rruga e Vermoshit, që është një rrugë shumë e mirë dhe tashmë e përfunduar, por për të cilën kanë nevojë ta dinë edhe më shumë qytetarët, sidomos në Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë, pasi Palava dhe Guçia jo vetëm kanë një bukurri mahnitëse, por janë edhe nga vatrën më të zjarrta të atdeshdashurisë dhe të çështjes kombëtare.

Ministri i Diasporës: Kërkohe ndryshim i formulës së zgjedhjes së deputetëve

Vota e emigrantëve, Majko: Duhet të prekim Kushtetutën

"Komisioni i reformës zgjedhore duhet të marrë një vendim"

Përfshirja e votës së emigrantëve në Kodin Zgjedhor do të kërkojë ndryshime kushtetuese", deklaroi dje ministri i Diasporës, Pandeli Majko, në një intervistë për ERTV. "Ajo që unë kam frikë është në duhet të prekim Kushtetutën. Pasi një nga sistemet apo modeli i përshtatshëm për pjesëmarrjen e diasporës do të kërkojë ndryshimin e formulës së zgjedhjes së deputetëve. Për fat të keq jemi treguar shumë detajistë për sa i përket Kodit Zgjedhor në ndryshimet kushtetuese të 2009-es, për shkak të mosbesimit që kishin palët", u shpreh ndër të tjera Majko. Duke folur për vështirësitë që ka votimi i shqiptarëve të diasporës, një premtim ky i hershëm i socialistëve. Majko tha se ka gati edhe propozimet që çojnë tek një zgjidhje. "Një nga shanset që kemi dhe që mund të kryhet pa shpenzime. Të gjithë shtetasve shqiptarë tani u plotësohet 10-vjeçari i përdorimit të dokumenteve të identifikimit. Do të thotë të gjithë duke filluar nga Presidenti i Republikës duhet të ribëjnë pasaportat. Është momenti kur të specifikohet dhe adresa dhe të vendoset ajo permanente jashtë shtetit. Jo adresa që kanë pasur kur jetonin në Shqipëri", u shpreh Majko. Më tej në intervistë, Majko foli edhe për miratimin në Kuvend të rezolutës për diasporën: "Rezoluta është një dokument fundor, i cili profillozi përfundimisht politikën zyrtare të shtetit shqiptarë kundrejt diasporës. Kjo erdhi edhe si refleksion i miratimit, në një periudhë ndoshta nga më të shkurtrat të parlamentit shqiptar të tri ligjeve, Ligjit për Diasporën, Ligjit për Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhe Ligjit për Fondin e Zhvillimit të Diasporës. Brenda këtij trekëndëshi janë duke u përgatitur një varg aktesh", tha Majko. "Sa i përket rezolutës, pavarësisht se opozita nuk ishte prezente në votim, ajo ka qenë prezente në diskutimin që është bërë në komision. Fillimisht kanë qenë përfaqësuesit e LSI-së dhe mbledhjen e fundit kur është miratuar rezoluta kanë qenë edhe përfaqësues të PD-së. Sa i përket pjesëmarrjes në seancë, ky është një vendim politik që nuk ka të bëjë me rezolutën", u shpreh ministri Majko. Përsa i përket çështjes së votimit, ministri Majko theksoi se, "votimi është një moment i rëndë"



Ministri i Diasporës, Pandeli Majko

sishëm, por që unë në përgjithësi kam qenë i rezervuar për të dhënë një formulë fundore për këtë çështje. Dua të theksoj që rezoluta e nënvizon dhe i kërkon komisionit të reformës zgjedhore të mar-

rë një vendim për këtë çështje sa më shpejt, pasi i takon këtij komisioni që të vendosë dhe unë u jam shmangur debateve të natyrave të tilla në publik, pasi mendoj që kolegët e mi qofshin të ma-

jtë, qofshin të djathtë në encë janë shprehur pro votës së shtetasve tanë jashtë vendit. Kjo ka shumë rëndësi. Ajo që ne po diskutojmë aktualisht është mënyra sesi do ta realizojmë atë".

THIRRJA
"Unë u jam shmangur debateve të natyrave të tilla në publik, pasi mendoj që kolegët e mi qofshin të djathtë, në esencë janë shprehur pro votës së shtetasve tanë jashtë vendit. Kjo ka shumë rëndësi. Ajo që ne po diskutojmë aktualisht është mënyra sesi do ta realizojmë atë", tha dje ministri i Diasporës.

Thirrjet antishqiptare në Kruhë, para Ivanov. MJ në Tiranë: Nxitësit të vihen para drejtësisë

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme ka dënuar gjuhën e urrejtjes ndaj shqiptarëve të përdorur gjatë përkuqimit të kryengritjes së Ilindinit në Kruhë. MEPJ në reagim të saj shprehet: "Besojmë se këto janë veprime të një grupi të vogël njerëzish të xixur nga ndjenjat nacionaliste ekstreme dhe shprehim që incidente të tilla, që ndjellin urrejtje ndëretnike të mbeten të izolura. MEPJ u bën thirrje institucioneve përgjegjëse që të hetojnë nxitësit e dhunës dhe vendosin e tyre para drejtësisë. Shqipëria dhe shqiptarët kanë qenë dhe do të jenë miq të përhershëm të Maqedonisë. Ne besojmë në vlerat e bashkëjetesës, në harmoninë dhe bashkëpunimin mes vendeve dhe qytetarëve tanë", shprehet MEPJ në një njoftim për mediat. Incidenti u shënuar paditën e së enjtes (2 gusht) në momentin që përfaqësues qeveritar vendosën kurora me lule pranë përmendore së kryengritësve të Ilindinit. "Shqiptari i mirë, shqiptari vdekur" ishin thirrjet raciste që u dëgjuan gjatë ceremonisë, ku merrte pjesë dhe presidenti maqedonas, Gjorge Ivanov.

REFERENDUM PËR PRESHEVËN

Thaçi: Nuk do të ketë ndarje të Kosovës, as autonomi të Veriut

Presidenti Hashim Thaçi siguron se marrëveshja me Serbinë nuk përkthehet me ndarje të Kosovës. Ai u tregua i prerë në këtë qëndrim, në një konferencë të posaçme për shtyp, si kundërpërgjigje ndaj zërave se po ia dorëzon Beogradit Mitrovicën e Veriut, duke thënë se synimi është futja në territorin e Kosovës të Luginës së Preshevës. "E theksoj nuk do të ketë as ndarje të Kosovës, as autonomi, as shkëmbim. Po punojmë që Presheva, Medvegja e Bujanovci t'i bashkëngjiten Kosovës", tha ai. Për kërkesën e Luginës për t'u bashkuar Kosovës, Thaçi tha se fjalën e fundit do ta ketë populli, që do të thirret në referendum. "Do të punojmë të instalojmë të drejtën e referendumit që për çështje madhore vetë qytetarët e Kosovës pa dallime partiake ta japin opinionin dhe të vendosin për atë çështje, për të mos mbetur peng i çështjeve politike, grupe, individuale populiste, elektorale. Le të deklarojnë vetë qytetarët e Kosovës a duan bashkëngjiten Preshevës, Medvegjes dhe Bujanovcit me Kosovën, po ose jo. A duhet që të fillojë dialogu Kosovë-Serbi dhe të arrihet marrëveshja përfundimtare, e cila nënkupton njohjen e Serbisë për Kosovën dhe njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe NATO". Duke iu përgjigjur skepticizmit dhe akuzave për shitje të Kosovës, presidenti Thaçi tha detaje për atë që ai e ka quajtur si korrigjim i kufirit me Serbinë. "E theksoj do të jenë rreth 400 km mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Kushdo që përfaqëson opinion tjetër duhet të jetë i bindur se Kosova dhe Serbia herët a vonë do të përballen me këtë realitet", tha ai.

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e dorezuesin K S të ndodhur në Panfishorë Mallëkaster. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:

- Pasuria "Are" nr. 206/48 vol. I fq.31, me sipërfaqe 2500 m2 ZK 2869, me cmm 1.500.000 lekë
- Pasuria "Are" nr. 206/7 me vol. I, faqe 244, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869, me cmm prej 100.000 lekë
- Pasuria "Are" nr. 70/15, vol. I, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në zonën Kadastrale 2869 me cmm në masën 520.832 lekë

Ankandi është progresiv e do të zhvillohet dt. 16.08.2018 në orën 15:00 në Bulev "G.Fishta" Kulla 1, Kat. 2, zyra.5. Kont. tel. 672082543, e-mail: tllir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

Platforma e bashkëqeverisjes, kryeministri publikon raportin

Rama: Zgjidhëm 13 700 probleme, u ndëshkuan 420 punonjës në 10 muaj

"Kjo është fuqia jonë kundër parazitizmit në zyrat e shtetit"

13732

RASTE

Ky është numri i rasteve që kanë marrë zgjidhje jo më vonë se 10 ditë nga dita që është regjistruar në portalin 'shqiperiaqeduam.al'. Këtë e bën të ditur kryeministri Rama, ndërsa ka publikuar raportin e 10 - muajorit të punës.

Darina Tanushi

Në 10 muaj, që kur u ngrit, 15 174 qytetarë i janë drejtuar platformës së bashkëqeverisjes për t'u ankuar për korrupsionin dhe zvarritjet që hasnin në sportelet publike. Nga këto 13 732 raste, sipas raportit, kanë marrë zgjidhje jo më vonë se 10 ditë nga dita që është regjistruar në portal. Por, rreth 420 punonjës të administratës janë ndëshkuar. Kryeministri Edi Rama publikoi dje raportin për punën e bërë nga ky portal, që e premtori në fushatë si mekanizmin që do të luftonte korrupsionin dhe paafësinë në administratën shtetërore. Rekordin e ankesave prej 5363 të tilla e mban Ministria e Drejtësisë, që ka në varësi drejtori si hipotekat, ALUIZNI-n apo Agjencinë e Pronave. Por ka edhe numrin më të lartë të çështjeve që kanë marrë zgjidhje, 4681. Edhe numrin më të madh të punonjëseve të larguar nga puna dhe të denoncuar pranë organeve të drejtësisë e ka po ashtu Ministria e Drejtësisë. Për 239 zyrtarë dhe punonjës të këtij dikasteri janë marrë masa administrative, nga 420 të tilla të dhëna për punonjësit e 9 ministrive.

239

PUNONJËS
Për 239 zyrtarë dhe punonjës të institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë janë marrë masa administrative, nga 420 të tilla të dhëna për punonjësit e 9 ministrive.

INSTITUCIONI	ANKESA IME NIVEL QENDRORE	
	TOTAL	TOTAL TË PËRFUNDUARA
KRYEMINISTRIA	3134	2701
MINISTRIA E DREJTËSISË	5363	4681
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE	1415	1368
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË	1251	1202
MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË	1400	1317
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË	891	836
MINISTRIA E BRENGSHMË	636	605
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT	349	322
MINISTRIA E BULJËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	193	187
MINISTRIA E MBROJTJES	166	159
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME	109	106
MINISTRIA E KULTURËS	56	54
MINISTRIA E SHITETIT PËR DIASPORËN	18	18
MINISTRIA E SHITETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES	193	176

fuqizon qytetarin. Vendos qeverinë gjithnjë e mënjherë në krah të tij. Garanton ndërveprimin e suksesshëm mes tyre në të mirë të çdo qytetari dhe identifikimin e punonjëseve që duhet të mbajnë përgjegjësi për mosdhënien e shërbimeve të duhura për qytetarët", tha Rama. "Nuk ka më asnjë dyshim! Platforma 'shqiperiaqeduam.al' është rruga jonë e re, e shkurtër dhe e shpejtë, për të zgjidhur së bashku hallet e problemet tuaja me administratën. Po ashtu, 'shqiperiaqeduam.al' është edhe fuqia jonë e përbashkët kundër parazitizmit e korrupsionit në zyrat e shërbimeve të shtetit për qytetarin. Mos ngurroni dhe as mos humbni kohë! Zgjidhni 'shqiperiaqeduam.al' për të zgjidhur hallin a problematikën tuaj, duke e përcjellë fjalën tuaj drejt e në qeveri dhe kësajherë ndikoni edhe që, hap pas hapi në çdo zyrë të shtetit tonë njerëzit e zakonshëm të marrin në kohë e me cilësi, shërbimin që meritojnë", u bëri thirrje qytetarëve kryeministri.

meve të duhura për qytetarët", tha Rama. "Nuk ka më asnjë dyshim! Platforma 'shqiperiaqeduam.al' është rruga jonë e re, e shkurtër dhe e shpejtë, për të zgjidhur së bashku hallet e problemet tuaja me administratën. Po ashtu, 'shqiperiaqeduam.al' është edhe fuqia jonë e përbashkët kundër parazitizmit e korrupsionit në zyrat e shërbimeve të shtetit për qytetarin. Mos ngurroni dhe as mos humbni kohë! Zgjidhni 'shqiperiaqeduam.al' për të zgjidhur hallin a problematikën tuaj,

duke e përcjellë fjalën tuaj drejt e në qeveri dhe kësajherë ndikoni edhe që, hap pas hapi në çdo zyrë të shtetit tonë njerëzit e zakonshëm të marrin në kohë e me cilësi, shërbimin që meritojnë", u bëri thirrje qytetarëve kryeministri.

BERISHA



"Narkoshteti drejt falimentimit, nuk ka para për të paguar rrogat"

Deputetja e PD-së: PD do të anulohet çdo koncesion

Tabaku: Rama i dha të vëllait monopolin e tregut të bixhozit



Deputetja demokratike tha se ligji ul taksat për bixhozin nga 25 për qind që ishte në 2013-ën, në 15 për qind. "Edi Rama jo vetëm nuk i largoi pikat e bixhozit nga qytetet dhe nga shkollat, por u uli atyre taksat në mënyrë të ndjeshme. Kur ligji të hyjë

në fuqi në 1 janar 2019, tati mi mbi fitimin e biznesit të bixhozit nuk do të jetë më 25 për qind, por gati është përgjysmuar, në 15 për qind", u shpreh Tabaku. "Partia Demokratike është e vendosur të anulohet çdo ligj selektiv, çdo koncesion që është monopol dhe çdo fa-

"Edi Rama jo vetëm nuk i largoi pikat e bixhozit nga qytetet dhe nga shkollat, por u uli atyre taksat në mënyrë të ndjeshme. Kur ligji të hyjë në fuqi në 1 janar 2019, tati mi mbi fitimin e biznesit të bixhozit nuk do të jetë më 25 për qind, por gati është përgjysmuar, në 15 për qind"

vorizim nga ata që sot qeverisin me krimin e organizuar dhe po pasurojnë paratë në ekonomi. Rishikimi i ligjit antitafia do të sigurojë që çdo qindarkë e krimin të organizuar dhe korrupsionit të kthehet në ekonomi", theksoi deputetja e PD-së.

Partia Demokratike nëpërmjet deputetes Jorida Tabaku akuzoi dje kryeministrin se i ka dhënë vëllait të tij, Olsi Rama monopolin e kontrollit të tregut të bixhozit. Sipas Tabakut, tarifa që pikat e basteve do të paguajnë për mirëmbajtjen me hyrjen në fuqi të ligjit nuk do t'i shkojë buxhetit, por kompanisë së vëllait të kryeministrin. "Ajo që dihet deri tani është se me ligjin e vitit 2015, Edi Rama detyron pikat e basteve të bëjnë pagesën e mirëmbajtjes së sistemit jo në shtet, por tek kompania koncesionare. Kjo do të thotë se sa më shumë pika basteve të operojnë në Shqipëri, aq më i madh është fitimi i kompanisë koncesionare që, zyrtarisht operon në emër të ortakut të vëllait të kryeministrin. Kjo është arsyeja pse në treg, në vitin 2013 ishin 928 pika basteve dhe 4 vjet pas ardhjes në pushtet të Edi Ramës, pikat e basteve janë katërfishuar, duke numëruar 4230 të tilla",

Ish-kryeministri Sali Berisha me një postim në rrjetet sociale denoncon faktin se shteti është drejt falimentimit. Ai i referohet mesazhit të "nëpunësit digital", i cili i shkruan se shteti ka dy muaj probleme me likuidimet dhe se paga e lindjeve të qershorit akoma nuk është paguar. Ndër të tjera në mesazh thuhet gjithashtu se në shtator do të falimentojnë dy kompani të mëdha, ku dëmi do të jetë 5000 të papunë. "Përsëritet dje dr. shteti nuk ka më lekë, u bënë 2 muaj që ka problem me likuidimet e pagave, paga e lejeve të lindjeve të qershorit akoma nuk është paguar. Muajin gusht ka rrezik s'do paguajnë as pensionet. Kjo është gjendja alarmante. Tatimet kanë dalë në terren të mbledhin sa më shumë. KM u ka vlerë gjoa bizneseve në vlera 1mn dollar që të dalë nga kjo krizë. Në muajin shtator falimentojnë 2 kompani të mëdha, dëmi do të jetë rreth 5,000 të papunë. Bankat kanë 3 muaj që e dine dhe nuk japin kredi dhe asgjë".

Njësitë e autoriparimit dhe shitblerjes së automjeteve do të kalojnë në "sitën" e strukturës së re

Ornela Manjani

Qeveria ka krijuar një strukturë të posaçme për kontrollin e serviseve dhe njësitë të shitblerjes së automjeteve. Përmes së vendimi të posaçëm, i cili ka hyrë në fuqi dy ditë më parë dhe do të shtrijë efektet deri në fund të vitit 2019, taks-forca e krijuar rishitas do të kalojë në "sitë" njësitë e autoriparimit, shitblerjes, depozitimit të mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe të pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit dhe të braktisura, si dhe veprimtaritë që lidhen me to. Struktura që do të jetë në varësi të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë do të ketë 40 punonjës. "U vendos krijimi i Task-Forcës, si një strukturë e posaçme e përkohshme, për përmirësimin e nivelit të kontrollit rrugor të mjeteve motorike e rimorkiove, që shërbejnë për përdorimin ekonomik të tyre, për transport pasagjerësh e mallrash, si dhe kontrollin e njësitë të autoriparimit, shitblerjes, depozitimit të mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit, ose të braktisura dhe veprimtaritë që lidhen me to. Kjo Task-Forcë është në varësi të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ka në përbërje 40 punonjës të specializuar, të cilët kontraktohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Drejtuesi i kësaj strukture duhet të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën e menaxhimit dhe të realizimit të shërbimeve në transportin rrugor. Sipas vendimit, struktura organizative, përshtetja e detajuar i detyrave dhe emërimi i punonjësve miratohen me urdhër të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë", - thuhet në pikën 1 të vendimit, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.

Kontrollet Task-Forca do të kryejë kontrollin në terren, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë vendim dhe akteve ligjore në fuqi, për zbatimin e ligjshmërisë së aktivitetit të njësitë të autoriparimit, shitblerjes, depozitimit të mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe të pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit dhe të braktisura, si dhe veprimtaritë që lidhen me to. Në fokus do të jetë kontrolli i oficinave e certifikimit të aparateve të regjistruar të shpejtësisë dhe të kohës (tahografëve) dhe terminalëve të linjave të rregullta të transportit të udhëtarëve, si dhe në vendqëndrimet e taksive. Taks-forca do të kryejë kontrollin e vendeve të shoqërive të transportit rrugor të pasagjerëve dhe të mallrave dhe vendeve të depozitimit të ngarkesave, ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave si dhe veprimtaritë të tjera të fushës së transportit rrugor, në përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, që do

Zbardhet VKM-ja, krijohet Taks-Forcë për kontrollin e serviseve

Vendimi hyn në fuqi sot dhe zgjat deri në fund të 2019-ës



Forcës, gjatë ndalimit të veprimtarive të kundërligjshme, që konstatohen gjatë ushtrimit të detyrës në terren. Sipas vendimit, taks-forca do të kryejë bashkëpunimin me strukturat e Policisë Rrugore për ndjekjen me përparësi të kallëzimeve të depozituara për shkeljet në këtë aktivitet prej operatorëve apo individëve të ndryshëm dhe kontrollin e zbatimit të detyrave të lëna për strukturat që ofrojnë shërbime për transportin rrugor dhe institucionet e tjera të ngarkuara në përputhje me këtë vendim. Task-Forca do të ndihmohet nga sekretariati teknik në detyrat administrative. Ngarkohet ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për ngritjen e këtij sekretariati dhe për përcaktimin e përbërjes dhe mënyrës së funksionimit të tij dhe do të raportojë në mënyrë periodike pranë Këshillit drejtues të DPSH-TRR-së për konstatimet dhe masat e marra në mënyrë periodike. Këshilli drejtues i DPSH-TRR-së

PAGAT E PUNONJËSVE

1. Paguesa e drejtuesit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a.
2. Paguesa e anëtarëve të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b.
3. Paguesa e shefit të grupit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-a.
4. Paguesa e specialistit të grupit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-b.
5. Paguesa e sekretarit/sekretares të/së drejtuesit të Task-Forcës përcaktohet në masën 30 000 lekë/ muaj.
6. Shpenzimet për dieta, fjetje dhe transport për Task-Forcën, sipas vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar.
7. Shërbimet autorizohen dhe mbikëqyren nga kryetari i Task-Forcës.

shtrijë efektet deri në fund të vitit të ardhshëm, Task-Forca për realizimin e objektit të saj ka të drejtë të kryejë kontrollin e mjeteve në vende të veçanta, të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrin e Brendshëm. Kjo strukturë do të kryejë hartimin e një plani masash administrative dhe organizative për fuqizimin dhe rritjen e frytshmërisë së strukturave që ofrojnë shërbime për transportin rrugor, si dhe për evidentimin e ndalimit e përdorimit të kundërligjshëm në transportin rrugor të pasagjerëve dhe mallrave, të mjeteve që nuk plotësojnë kriteret tekniko-ligjore dhe bashkërendimin e punës me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të

Shërbimeve të Transportit Rrugor, Policisë Rrugore, Autoritetit Rrugor Shtetëror dhe institucionet e tjera shtetërore, për identifikimin dhe zbatimin e masave në funksion të garantimit të zbatimit të kërkesave tekniko-ligjore prej operatorëve ekonomikë, që kryejnë transport pasagjerësh dhe mallrash. Gjithashtu, kjo strukturë do të kryejë edhe bashkërendimin e punës me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Policisë Rrugore për ndërhyrjet e nevojshme për zbatimin e masave teknike dhe bashkërendimin e punës me strukturat e Policisë Rrugore, sipas qarqeve, për mbështetjen e veprimeve në terren të punonjësve të Task-

NJËSITË QË KONTROLLOJN TAKS-FORCA

1. Njësitë e autoriparimit, shitblerjes, depozitimit të mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe të pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit dhe të braktisura, si dhe veprimtaritë që lidhen me to.
2. Oficinat e certifikimit të aparateve të regjistruar të shpejtësisë dhe të kohës (tahografëve).
3. Terminalët e linjave të rregullta të transportit të udhëtarëve, si dhe në vendqëndrimet e taksive.
4. Vendet e shoqërive të transportit rrugor të pasagjerëve dhe të mallrave.
5. Vendet e depozitimit të ngarkesave, ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave.
6. Veprimtari të tjera të fushës së transportit rrugor, në përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

ka të drejtë të kërkojë informacion dhe të kryejë kontrollin për çdo çështje të vlerësuara të rëndësishme. Fondet e nevojshme për funksionimin, shpenzimet, si dhe për bazën e nevojshme materiale dhe

teknike do të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas detajimit të shpenzimeve të miratuara nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gati projekti për krijimin e mekanizmit të zgjidhjes së ankesave të investitorëve

Sekretariati i Këshillit të Investimeve këtë vit u përfshi në një proces diskutimesh mbi kuadrin ligjor aktual ekzistues për investimet, si edhe për të lehtësuar procesin e përgatitjes së një kuadri ligjor të harmonizuar me praktikën e mira ndërkombëtare. Nga takimet e zhvilluara si në nivel ekspertësh, ashtu edhe nga diskutimet në mbledhjen e KI u vlerësua si shumë i rëndësishëm roli i mekanizmeve shtetërore për zgjidhjen e ankesave të investitorëve që në fazat e hershme të këtyre ankesave, si dhe mundësia për të përfshirë një mekanizëm të tillë në ligjin për investimet. Qëllimi i ngritjes së mekanizmeve të tillë është dhënia e garancive ligjore për zbatimin e shtetit ligjor, zbatimit të parimit të parashikueshmërisë dhe të mundësisë efektive që kanë investitorët për të vënë në vend të drejtat e shkelura apo të mohuara nga ana e administratës. Praktikisht rajonale njohin disa modele për lehtësimin e punës së investitorëve. Maqedonia dhe



Kroacia nuk kanë një model të mirëfillt të Modelit të Zgjidhjes së Ankesave ndaj investitorëve, sepse nuk kanë një ligj të veçantë për investimet e huaja. Serbia ka një model që përkrahë kryesisht në mënyrë deklarative në ligjin përkatës për investime si garanci e përgjithshme për investitorët, por nuk është e qartë mënyra e trajtimit të ankesave, cilat ankesa mund të paraqiten apo afati i shqyrtimit të tyre. Greqia paraqet një model interesant të "Business Ombudsman", të përshtatur nga viti 2013 në

kuadër të "Enterprise Greece" (Agjencia e Promovimit të Investimeve) me fokus jo zgjidhjen çështjeve dhe ankesave si pjesë e ankimit administrativ, por në funksion të ndërmjetësimit për zgjidhjen e ankesave në fazën e tyre para-praktike. Juridiksioni i "Business Ombudsman" është i kufizuar vetëm sa u takon ankesave që lidhen me procedurat e licencimit të investitorëve. Këto mekanizma shikohen si pjesë e shërbimit të kujdesit (aftercare) të kryera nga Agjencia e Promovimit të Investimeve apo institucione të tjera, të cilat ngrihen për qëllime të ndërmjetësimit të konflikteve midis investitorëve (biznesit) dhe administratës publike. Përgatitja e një modeli të caktuar lidhet me kuadrin ligjor dhe institucionin në fuqi në një vend të caktuar si edhe mbi problematikën, që synohen të zgjidhen nëpërmjet zbatimit të një mekanizmi të tillë, duke mbetur kështu në varësi të vendimmarrjes së qeverisë.

Vizitorët nisin prenotimet në hotelet e qytetit juglindor

Festa e Birrës ju fton 'Check in Korça', sipari çelet më 8 gusht, 5 net argëtim dhe surpriza

KORÇË - Argëtim, muzikë dhe birrë deri në orët e para të mëngjesit. Korça është gati të hapë dyert edhe këtë vit për Festën e Birrës, e cila për mëse një dekadë identifikohet me traditat e qytetit si edhe birrën e saj. Nën sloganin "Check in Korça", Festa e Birrës këtë vit do të çelë siparin më 8 gusht dhe do të mbajë zgjuar deri në agim vizitorët vendës e të huaj, që do të bëhen pjesë e saj për 5 net me radhë, nga 8 deri me 12 gusht. Ashtu si çdo vit, kjo festë parashikohet të ketë një rekord pjesëmarrësish, ndërsa hotelet në Korçë kanë nisur prenotimet për të pritur ju vetëm pije-dashës që dinë të vlerësojnë shijen e birrës me të mirë, por edhe adhurues të



traditave të qytetit. Edhe në këtë edicion organizatorët e festës janë kujdesur në deta-

je për të sjellë një program muzikor mjaft të mirë, me emrat më të njohura të muzikës shqiptare dhe jo vetëm, ndërsa hyrja për të gjithë vizitorët vendës e të huaj që do të marrin pjesë në festë do të jetë falas. Festa me e madhe verore në Shqipëri do të vijë e organizuar në dy pole, tek Pazar i Vjetër dhe tek sheshi para stadiumit "Skënderbeu". Birra "Korça" këtë vit vihet edhe më tepër në gendër të vëmendjes, pasi bëhet fjalë për një vit jubile, i cili përkon me 90-vjetorin e krijimit të

saj, ndërsa organizatorët premtojnë surpriza të mëdha. Turistët dhe të apasionuarit e festës do të kenë mundësi të shijojnë birrën, e cila është vlerësuar edhe nga ekspertët ndërkombëtarë si një prej birrave më cilësore. Veç birrës, pjesëmarrësit do të kenë mundësi të shijojnë edhe gatimet tradicionale. Me idenë e iniciativën e fabrikës birra "Korça", në bashkëpunim me pushtetin vendor, qyteti juglindor ka prej mëse një dekadë një festë gjigante. Festivali është nderuar me çmim-



in e Turizmit nga Ministria e Kulturës në vitin 2010, për shkak të influencës që pati në rritjen e numrit të turistëve në rajon. Pushimet

nuk kanë përfunduar, ndaj nëse ende nuk keni planifikuar asgjë, Korça ju fton të bëni një 'Check in' në Festën e Birrës.

ALUIZNI do të marrë 140 persona në rolin e specialistit

Hapen 200 vendet të reja punë në administratë

Punonjës të përkohshëm, ja dikasteret ku mund të konkurroni

Numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore është shtuar me 200 punonjës. Qeveria ka ndryshuar vendimin e datës 31 janar 2018, ku ishte vendosur që numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme në institucionet shtetërore të ishte 1 752. Vendim ky që është ndryshuar nga Këshilli i Ministrave, duke e rritur numrin e punonjësve në administratë me rreth 200 të tillë. Kështu, deri në fund të vitit 2018 numri i punonjësve të përkohshëm në administratë do të jetë 1989 punonjës. Numrin më të lartë të punonjësve me kontratë të përkohshme e ka Ministria e Drejtësisë, e cila ka punësuar edhe 150 persona nga 487 që ishin miratuar në janar 2018. Këta persona do të punësohen të gjithë pranë ALUIZNI-t, ku 140 do të jenë në rolin e specialistit dhe 10 të tjerë si teknikë të mesëm. Kontrata e tyre do të jetë 6-mujore. Punonjës do të shtohen edhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të Energjisë, të Arsimit si dhe në institucionet e tjera qeveritare, duke përfshirë edhe shërbimin informativ. Aktualisht numrin më të madh të punonjësve me kontratë të përkohshme e ka Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ku rreth 300 punonjës janë të punësuar të Tatimit.

DOSJET

Sipas ligjit në fuqi, çdo institucion shtetëror, institucion i pavarur dhe njësi e qeverisjes vendore krijon dhe administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit të institucionit (dosja individuale). Dosja individuale përmban të dhënat profesionale për

Gr.	Emri i Institucionit	Numri punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	7			
	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	7	Punonjës Aktivi	6 orë ditë	6 muaj
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	10			
	Drejtoria e Përgjithshme të Takës së Pazarisë	8	Specialistë	8 orë ditë	6 muaj
	Dega e Thesant Vlorë	1	Specialistë	8 orë ditë	6 muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	1	punonjës arkivi	8 orë ditë	6 muaj
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	3			
	Qendrat Rajonale Ranore Turanë, Korçë dhe Vlorë	3	Saritar	4 orë ditë	6 muaj
13	Ministria Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale	4			
	Qendra Kombëtare Mgritëse, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve	4	Mjek	4 orë ditë	6 Muaj
14	Ministria e Drejtësisë	150			
	ALUIZNI	140	Specialistë	8 orë ditë	6 Muaj
	ALUIZNI	10	Teknikë të mesëm	8 orë ditë	6 Muaj
16	Ministria e Brendshme	2			
	Prefektura Turanë (Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë)	1	Arkivist	8 orë ditë	6 Muaj
	Prefektura Gjirokastrë (Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë)	1	Arkivist	8 orë ditë	6 Muaj
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	3			
	SHISH (Degët Autonome Tropojë, Pogradec, Hanarë)	3	Saritar	4 orë ditë	6 Muaj
87	Institucione të tjera qeveritare	20			
	Ajensia Kombëtare e Shoqësisë së Informacionit	20	Specialistë	8 orë ditë	6 Muaj
88	Ajensia e Mbrojtjes së Shoqërisë Civile	1			
	Ajensia e Mbrojtjes së Shoqërisë Civile	1	Specialist	8 orë ditë	6 Muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	200			

çdo të punësuar dhe nëpunës civil, si dhe çdo të dhënë tjetër, lidhur me marrëdhëniet e punës. Departamenti i Administratës Publike krijon dhe administrojnë Regjistrin Qendror të Personelit, që është një bazë unike shtetërore të dhënash, që përfshin të dhënat profesionale dhe të dhënat e tjera

për marrëdhëniet e punës të çdo të punësuarit në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore. Çdo institucion i administratës shtetërore, institucion i pavarur dhe njësi e qeverisjes vendore është i detyruar të japë të dhënat e përcaktuara në ligj.

Këshilli i Ministrave përcakton rregulla të hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe Regjistrin Qendror të Personelit, të dhënat që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe të përdorimit të të dhënave.

Aksionet kundër informalitetit

Tatimet bllokojnë bizneset turistike në veri të vendit

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka intensifikuar kontrollin në subjektet pranë zonave turistike. 890 kontrole janë kryer nga strukturat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor, rajoni verior në Velipojë, Shëngjin, Tale, Patok, Razëm, Valbonë etj..



Nga data 22 qershor, 375 subjekte kanë rezultuar me shkelje tatimore me vlerë rreth 12.5 milionë lekë. Më konkretisht, sipas të dhënave të DPT-së, 43 subjekte janë konstatuar të paregjistruara në organet tatimore me aktivitet hotelieri, bare-restorante etj.; 9 subjekte rezultuan me mospagisje me kasë fiskale dhe 26 subjekte për mosmbajtje kase në gjendje pune; 71 subjekte rezultuan me "moslëshim kuponit tatimor" (herë e parë); 6 subjekte rezultuan me "moslëshim kuponit tatimor" (herë e dytë). Për këta tatimpagues u mor masa e bllokimit të aktivitetit për 30 ditë kalendarike. 55 subjekte rezultuan me punonjës të padeklaruar. 58 subjekte rezultuan me mallra të pashoqëruara me dokumentacion tatimor (fatura), 14 subjekte rezultuan me shitje pa faturë tatimore, 55 subjekte rezultuan me mungesë dokumentacioni, kontrata qiraje etj. Si rezultat i penaliteteve për përdorimin e pajisjeve fiskale, për subjektet e kontrolluara ka rezultuar rritje xhiros me 30%. Kjo krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë", thuhet më tej në njoftimin e DPT-së.

I dënuar më parë për prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve"

Furnizonte me armë grupet kriminale në Tiranë, arrestohet 64-vjeçari

Një 64-vjeçar ka përfunduar ditën e djeshme në prangat e policisë së Tiranës, pasi dyshohet se furnizonte me armë grupe kriminale. Në kuadër të operacionit të koduar "Baza", uniformat blu arrestuan shtetasin Ramadan A., pasi e kishte përshatur banesën e tij në një bazë, e cila iu shërbente personave që merren me veprimtari kriminale. Operacioni u finalizua nga Komisioni i Policisë nr.6, në bashkëpunim me specialistët për Hetimin e Krimeve në D.V.P. Tiranë dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor. Policia bën me dije se gjatë kontrollit të

ARMËT
Policia bën me dije se gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e 64-vjeçarit u sekuestruan një arsenal armësh dhe municion luftarak. Konkretisht, 3 armë zjarri (automatik model 56 dhe dy pushkë gjysmë automatike), 4 armë zjarri të çmontuara (3 snajpera dhe 1 armë sportive), dy armë sportive, municion luftarak i llojeve të ndryshme, silenciator dhe pjesë të ndryshme armësh zjarri.

ushtruar në banesën e 64-vjeçarit u sekuestrua një arsenal armësh dhe municion luftarak. Konkretisht, 3 armë zjarri (automatik model 56 dhe dy pushkë

gjysmë automatike), 4 armë zjarri të çmontuara (3 snajpera dhe 1 armë sportive), dy armë sportive, municion luftarak i llojeve të ndryshme, silenciator dhe pjesë

të ndryshme armësh zjarri. Për arsye hetimi nuk bëjmë me dije të dhëna të tjera. Ndërkohë, Ramadan A. është emër i njohur për policinë, pasi rezultoi i dënuar më



parë për "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak". Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shteta-

tit të lartpërmendur për veprat penale të "Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta".

Nëna e vajzës 7 vjeçe u hodh nga kati i 5 i pallatit ku banonte

Vetëvrasja e gruas së gjyqtarit Hallunaj, 37-vjeçarja vuante nga një sëmundje e rëndë

Bashkëshorti ishte në Shkodër kur mësoi lajmin e vdekjes

Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në kryeqytet, ku bashkëshortja e gjyqtarit Dritan Hallunaj i dha fund jetës duke u hedhur nga kati i 5-të i pallatit ku banonte, të tjera detaje dalin në dritë. Mësohet se 37-vjeçarja Enkelajda Hallunaj, pak minuta para se të hidhej nga ballkoni, ndodhej bashkë me vajzën te prindërit e saj, që jetonin pranë saj. Enkelajda Hallunaj ka lënë vajzën te prindërit dhe ka shkuar në apartamentin e saj për të marrë mjekimin e përditshëm, pasi vuante nga një sëmundje e rëndë. Pikërisht në këtë kohë, kur ndodhej e vetme në apartamentin e saj në Tiranë, 37-vjeçarja është hedhur nga lartësia duke gjetur vdekjen e menjëhershme. Bashkëshorti i saj, gjyqtari Hallunaj, atë ditë ishte larguar për një vizitë në Shkodër tek të afërmit e tij.

NGJARJA

Enkelajda Hallunaj me profesion stomatologe është vetëvrasëse mesditën e së enjtes, duke u hedhur nga një pallat në rrugën "Vaso Pasha" në Tiranë. Sipas uniformave blu, ngjarja ka ndodhur në orën 13:16. 37-vjeçarja është hedhur nga ballkoni i banesës në katin e pestë. "Më datë 02.08.2018, rreth orës 13:16, në rrugën 'Vashko Pasha' dyshohet të jetë hedhur nga ballkoni i pallatit shtetasja E. H., rreth 37 vjeçe, e cila ka gjetur vdekjen e menjëhershme. Po punohet për sqarim të mëtejshëm të rrethanave të ngjarjes", thuhet në njoftimin e policisë. E lindur në qytetin e Shkodrës, Enkelajda Hallunaj në vitin 2004 mbaroi Fakultetin e Mjekësisë, dega Stomatologji. Në vitet 2004-2006 punoi si mjekë stomatologe në Shërbimin parësor në Shkodër dhe më pas në vitin 2006 dhe në vazhdim punoi mjekë stomatologe pranë Autoritetit Shëndetësor Racional në Tiranë. Dyshohet se



Gjyqtari Dritan Hallunaj



37-vjeçarja Enkelajda Hallunaj

ENKELAJDA HALLUNAJ

Mësohet se 37-vjeçarja Enkelajda Hallunaj pak minuta para se të hidhej nga ballkoni ndodhej bashkë me vajzën te prindërit e saj, që jetonin pranë saj. Enkelajda Hallunaj ka lënë vajzën te prindërit dhe ka shkuar në apartamentin e saj për të marrë mjekimin e përditshëm, pasi vuante nga një sëmundje e rëndë.

37-vjeçarja e ka ndërmarrë këtë veprim në kushtet e një gjendjeje të rënduar. Deri para pak minuta para se të hidhej nga ballkoni, ndodhej bashkë me vajzën te prindërit e saj, që mësohet se jetonin pranë saj. Burimet thanë se 37-vjeçarja ka lënë vajzën e mitur te prindërit dhe ka shkuar në apartamentin e saj për të marrë mjekimin e përditshëm, pasi vuante nga një sëmundje e rëndë. Në vendin e ngjarjes shkuan menjëherë ambulanca dhe makina policie,

ndërsa efektivë të shumtë rrethuan zonën. Gjithashtu, të pranishëm ishin edhe drejtues të policisë e prokurorisë, por edhe kolegë të gjyqtarit Dritan Hallunaj. Ndërsa fqinjët e familjes Hallunaj që u bënë dëshmitarë të ngjarjes treguan minutat e para pas aktit tragjik. Ata kanë rrëfyer se kanë dëgjuar një zhurmë të fortë dhe kanë dalë jashtë. "Kemi dëgjuar një zhurmë, ishte aq e fortë sa nuk munduam se ishte një trup njeriu. Ka qenë vetëm në sh-

tëpi, sepse nuk kemi parë njerëz të tjerë të dalin. Kanë qenë disa kalimtarë duke kaluar, janë tromaksur. Ne lajmëruam policinë menjëherë", u shprehën kalimtarët. Nuk dihet se cilat kanë qenë arsyet e këtij veprimi ekstrem, ndërsa në vendngjarje nisën menjëherë hetimet e para. Mësohet se gjyqtari i Krimeve të Rënda ishte në Shkodër kur mori vesh për ngjarjen, duke u nisur drejt kryeqytetit. Ngjarja e rëndë ndodhi një ditë pasi bashkëshorti i saj, Dritan Hallunaj kaloi vetingun, duke u konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Gjyqtari doli i pastër në tri shtyllat e kontrollit dhe nuk u konstatuan problematika me pasuritë e tij. Por rikonfirmimi i tij në detyrë solli pakënaqësi tek opozita, e cila rikujtoi vendimin e gjyqtarit Hallunaj për lirimin e Arben Frukut.

KPK: S'ka fshehje të pasurisë

Vetingu, prokurori Arben Dollapaj drejt konfirmimit

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar ditën e djeshme seancën dëgjimore me prokurorin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, Arben Dollapaj. Ai u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të komisionit. Sipas Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, pasuria e Dollapaj është e justifikuar. Trupa e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit e përbërë nga Brunilda Bektashi, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici u shprehën se nga verifikimi i ILD-KPKI dhe i vetë komisionit ka rezultuar se prokurori nuk ka shkelje dhe fshehje të pasurisë. Ai është pjesë e listës prioritare, për shkak të funksionit si prokuror i Apelit në Shkodër dhe kandidimit të tij për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Nga hetimi i thelluar i KPK-së, Arben Dollapaj rezultoi me pasuri të justifikuar. Sipas KPK-së, Dollapaj ka një apartament me sipërfaqe 76 metra katrorë në Bajram Curri, një shtëpi banimi me sipërfaqe 113 m² në Selitë të Vogël, në kryeqytet me vlerë 9 milionë lekë; si dhe një shtëpi banimi në Valbonë të Tropojës, ku nuk kanë përfunduar ende punimet. Për shtëpinë në kryeqytet, të blerë në vitin 2011, si burim financiar janë kursimet personale, ndërkohë që ka marrë edhe një hua nga kunati prej 25 mijë dollarësh. Në përfundim të hetimit, KPK-ja thekson se nga deklarimet e provat e vëna nga subjekti gjithçka rezultoi korrekte, përfshi një leje legalizimi për shtëpi kati prej 123 metrash katrorë në shtëpinë e blerë në vitin 2011, pasi konfirmohen edhe nga zyra e legalizimit. Edhe raporti mbi pastërtinë e figurës, i ofruar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar rezultoi pozitiv për prokurorin e Apelit të Shkodrës. "Ka kryer me ndershmëri detyrën dhe me etikë të lartë profesionale, ka ruajtur të pastër figurën profesionale", rezultoi sa i përket vlerësimit të afësive profesionale të Dollapaj. Gjithashtu, ditën e djeshme kaloi me sukses vetingun, duke u konfirmuar në detyrë gjyqtari i Gjykatës Administrative të Apelit në Tiranë, Artur Malaj.

Vetëdorëzohen pas 24 orësh në polici dy ekzekutorët e të riut shqiptar

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Vrasja e 23-vjeçarit në Itali, babai: Viktorin e qëlluan në sy të vëllait

"Jemi të varfër, shteti të më sjellë trupin e pajetë të djalit që ta varrosim e të mos kemi mort përditë"

Ekzekutimi me dy plumba pas shpine i 23-vjeçarit shqiptar Viktor Picaku në Bari të Italisë ka tronditur familjarët e tij. Pas ngjarjes së rëndë të ndodhur mbrëmjen e së mërkurës në sheshin "Abbazia" në Corato, prindërit e viktimës i bëjnë apel shtetit shqiptar për të sjellë trupin e pajetë të djalit në atdhe. Familja Picaku nga Mirdita, e vendosur prej 24 vitesh në zonën e ish-Kënetës në Durrës ka hapur dyert e mortit. Ndërkohë, babai i të riut tregoi se si e mori vesh lajmin e kobshëm. Lek Picaku tha se i biri i qëllua për vdekje në sy të të vëllait, që ndodhej aty pranë. Gjithashtu, i moshuari pohoi se lajmin e hidhur e mori ditën kur do të festonin ditëlindjen e mbesës. "Nuk e di përse e vranë tim bir. Djali i madh, i cili është dëshmitar i ngjarjes, është ende i traumatizuar nga ajo që ndodhi. Ne jetojmë në kushte të vështira ekonomike dhe nuk kemi mundësi të sjellim në Shqipëri trupin e pajetë të djalit. I bëj thirrje shtetit të na ndihmojë. Të na sjellin trupin e pajetë. Ta varrosim, të mos kemi mort përditë", u shpreh i ati i Viktor Picaku. Ndërkohë, ai tregoi se ishte një telefonatë në drejtim të tyre që zbuloi ngjarjen e rëndë. "Ishte vetëm një telefonatë... Bërtiste... nuk merr frymë, ka ra, është vranë. S'kisha çfarë t'i thosha më. Unë e kuptova faktikisht se derisa nuk po flisnin...", tha Lekë Picaku. Sipas familjarëve, 23-vjeçari jetonte në Itali prej dy vitesh tek i vëllai i madh, i cili është i martuar. Ndërsa, një version i mediave italiane është që i riu shqiptar u ekzekutua pasi kishte mbrojtur një vajzë, të cilën po e ngacmonin dy autorët e krimit. Ndërkaq, mësohet se autorët e vrasjes së të riut shqiptar janë dorëzuar tek autoritetet.



23-vjeçari i vranë, Viktor Picaku



Babai i viktimës, Lek Picaku, duke folur për "GSH"

MOTIVI I KRIMIT

Sipas familjarëve, 23-vjeçari jetonte në Itali prej dy vitesh tek i vëllai i madh, i cili është i martuar. Ndërsa, një version i mediave italiane është që i riu shqiptar u ekzekutua pasi kishte mbrojtur një vajzë, të cilën po e ngacmonin dy autorët e krimit. Ndërkaq, mësohet se autorët e vrasjes së të riut shqiptar janë dorëzuar tek autoritetet.



Vendi ku ndodhi ngjarja

NGJARJA

Ngjarja e rëndë ku mbeti i vranë i riu shqiptar ndodhi rreth orës 21:35 të së mërkurës në sheshin "Abbazia" të Coratos, (provincë e Barit), në praninë e dhjetëra personave që kishin mbushur vendin. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, por edhe nga dëshmitarët e shumtë në vendin e ngjarjes, u bë me dije se 23-vjeçari u qëllua pas shpine nga dy persona që lëviznin me një motor "Scooter".

italiane që të ndihmuara dhe nga kamerat e sigurisë kishin identifikuar autorët duke e bërë më të arritshme mundësinë për kapjen e shpejtë të tyre. Ende nuk dihen motivet e vrasjes së 23-vjeçarit me origjinë nga Mirdita dhe i padënuar më parë,

me një reputacion të mirë në zonë. Sipas mediave, autorët nuk kishin si qëllim ta vrasin shqiptarin, por vetëm ta trembnin. Për momentin, të gjitha hipotezat mbeten të vlefshme, ndërsa do mësohet më shumë pas marrjes së pyetje të dy autorëve.

Lëvizja "5 Yjet" për vrasjen e shqiptarit: Dënim pa hezitim ndaj çdo akti dhune

ITALI - "Ngushëllimet më të sinqerta për familjen e Viktorit dhe dënimin pa hezitim të çdo akti dhune dhe paligjshmërie" është kjo deklarata e lëvizjes "Meetup Corato 232", adrese e lëvizjes "5 Yjet" në Itali, pas vrasjes së 23-vjeçarit shqiptar mbrëmjen e së mërkurës në sheshin "Abbazia të Coratos", në Bari. "Ky episod dramatik rikthen edhe njëherë në vëmendje problemin e sigurisë në qytetin tonë", thuhet në një deklaratë. "Pas ngjarjes absurde të së mërkurës në mbrëmje, i kërkojmë sërish kryetarit të bashkisë dhe këshillit që të marrin masa për të parandaluar dhe garantuar qetësinë maksimale për qetësinë e qytetarëve". Më tej, lëvizja thekson se "qyteti i Corato nuk duhet të presë më që të ndodhin raste të tilla të ngjashme për të vepruar". "Nuk është e mundur që një komunitet me 50 mijë banorë të mos ketë në dispozicion prani të mjaftueshme në territor të forcave të sigurisë për të garantuar sigurinë pub-



like". Dy janë autorët e vrasjes së shqiptarit Viktorjan Picaku. Domenico Manzi, 21 vjeç, është personi që e qëlloi të riut të paktën 4 herë me pistoletë dhe Domenico Patruno, 29 vjeç, bashkëpunëtor. Menjëherë pas krimit që ndodhi në sytë e dhjetërave personave që ndodheshin në vendin e ngjarjes, ata u arratisën, për t'u vetëdorëzuar disa orë më vonë. Patruno dhe Manzi janë marrë në pyetje dhe pritet zbardhja e shkakut të ngjarjes së rëndë. Mediat italiane shkruajnë se autori i kishte telefonuar

viktimën disa orë para ngjarjes, megjithatë ky fakt është mohuar nga 21-vjeçari gjatë marrjes në pyetje. Dyshimet janë se mes palëve kishte pasur një përplasje disa ditë para krimit, në qendër të së cilës ishte një vajzë. Edhe të afërmit e viktimës dyshojnë se shkak është bërë ndërhyrja e Viktorjanit për të mbrojtur një vajzë që po dhunohej nga një italian. Megjithatë, tashmë pritet që autoritetet italiane të japin një version zyrtar për ngjarjen e rëndë. /tvklan.al

Permbuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje ne ankand pasurine :

a) **Take are** e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 592/1, volumi 10, Faqe 248, ne zonen kadastrale nr 1100, me siperfaqe totale 3230 m2, e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder

b) **Take are** e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 5232/1, volumi 9, Faqe 3, ne zonen kadastrale nr 1100, me siperfaqe totale 360 m2, e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder.

2. **Cmimi** me të cilin do të llogjë shitja ne Ankand për pasurinë e sipërpërkohur, është në vlerën a) **Për pasurinë "Take Are"** me sip 3230 m2, është në vlerën 439,538 lekë.

b) **Për pasurinë "Take Are"** me sip 2360 m2, është në vlerën 321,148 lekë

Shija e pasurise do te behet (zhvillohet) me date 06.08.2018 ora 16.16 ne Zyren e permbareusit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko, Perballë Gjykatës se rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen para fillimit te ankandit 10% te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.

STRATI Shoqëria përmbareme "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen ne ankand te pasurive te paluajshme:

"Njësi" me sipërfaqe 62 m2, me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Kujtim Zhika, me Nr. Pasurie 5/27+4-2. Zona Kadastrale 8521, Volumi 34, Faqe 193, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 139 Rep., dhe Nr. 40/2 Kol., datë 19.01.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 11,577,384 Lekë.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 08.08.2018.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbareme "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Palli, 14/11, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

NJOFTIM

Ne date **08.08.2018** ne oren **16.00** ne zyren e permbareusit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankand per shitjen e pasurise se paluajshme te lojtit **"Apartment"** me sip.68 m2, me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjia 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5, Ure Vajgurore Berat.Cmimi ne ankand te trete eshte ne vleren **1,411,200 (nje milion e katerqind e njemdhete mije e dyqind) lekë.**



Gjatë Instalacionit të "Avullorja 02"

Arsyet pse "Avullorja 02" u instalua tek ish-Stacioni i Trenit në kryeqytet

Voltiza Duro

Altin Sukaj: Si e shpëtuan lokomotivën e fundit në Shqipëri

"Financimi nga 'Hemingway Fun Club', asnjë ndihmë nga institucionet"

Prej korrikut të këtij viti, instalacioni i lokomotivës së vetme me avull që i ka rezistuar kohës në vendin tonë u vendos në zonën e ish-Stacionit të Trenit në kryeqytet. Ky projekt erdhi si një ide e "Hemingway Fun Club", e mori miratimin e kryebashkiakut Erion Veliaj për t'u vënë në jetë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Altin Sukaj, një prej anëtarëve të këtij grupi e njehkohësist një prej ideatorëve të projektit tregon arsyet se pse "Avullorja 02" duhej të shpëtonte, si dhe sfidat që duhej të kalonin gjatë realizimit të projektit. Më tej, Sukaj thekson se financimi i projektit deri në finalizimin e tij u realizua nga "Hemingway Fun Club", pa përkrahjen e asnjë institucioni apo organizate tjetër.

Si lindi ideja për projektin "Avullorja 02", pra rikthimin në jetë të lokomotivës me avull në kryeqytet?

Ideja për këtë projekt ka lindur shumë natyrisht. U bë viti i katërt që "Hemingway Fun Club" realizon "Swing Maratonen", që është një maratonë e muzikës xhaz, që fillon nga Tirana me tren dhe përfundon në Shkodër, pra bëjmë 4 orë e gjysmë udhëtim të shoqëruar me muzikë në tren me banda që vijnë nga Italia, me njerëz që vijnë nga vende të ndryshme të botës. Pikërisht për këtë lindi ideja e risjelljes në jetë të një lokomotive të vjetër me avull.

Këtë projekt-ide ju e keni paraqitur pranë Bashkisë së Tiranës.

Fillimisht si u prit nga kryebashkiaku Veliaj?

Kjo ide është gati prej 3 vitesh dhe para 2 vitesh e kemi paraqitur në Bashkinë e Tiranës, që u mirëprit si ide. Pasi folëm me kryebashkiakun Erion Veliaj, ai e miratoi projektin dhe na dha hapësirën që ta vinim në jetë.

"Avullorja 02" është lokomotiva e vetme me avull që i ka rezistuar kohës?

Kjo është një lokomotivë e vjetër me avull e vitit

SFIDA

Ka qenë një sfidë e jashtëzakonshme për ne, shumë e vështirë, por ia dolëm. Ne e kemi mbuluar totalisht me financat tona të gjithë këtë proces pune, pra shpenzimet janë mbuluar nga "Hemingway Fun Club".



Altin Sukaj së bashku me dy vëllezërit e tij, anëtarë të "Hemingway Fun Club"

HISTORIKU

Kjo është një lokomotivë e vjetër me avull e vitit 1951, prodhim polak, e vetmja që ka shpëtuar nga 6 të tilla që ishin më parë e që i kanë shkrirë, ose i kanë çuar për skrap. Kështu që ishte e domosdoshme që të ruhej lokomotiva e vetme e fundit në vendin tonë.

1951, prodhim polak, e vetmja që ka shpëtuar nga 6 të tilla që ishin më parë e që i kanë shkrirë, ose i kanë çuar për skrap. Kështu që ishte e domosdoshme që të ruhej lokomotiva e vetme e fundit në vendin tonë. Fillimisht kjo lokomotivë u shërbu udhëtarëve dhe më pas trenave të mallrave.

Pse zgjidhët pikërisht ish-Stacionin e Trenit për ta instaluar këtë projekt?

Duke u nisur nga ideja që është jo vetëm një mjet pune, por edhe një mjet komunikimi që ka shërbyer në vite për Shqipërinë, ne menduam se ishte më e përshtatshme që lokomotiva të vendosej në ish-Stacionin e Trenit të Tiranës. Në këtë mënyrë do të mbahet mend se në këtë zonë dikur ka qenë stacioni i trenit më i famshëm në Shqipëri dhe nga ana tjetër për të kujtuar ato vite, ku prindërit tanë kanë marrë trenin, këtë lokomotivë për të udhëtuar. Të gjitha këto emo-

cione që kjo lokomotivë të jep e të risjell në kujtesë ato vite, meritonte që të qëndronte diku e të shihet nga të gjithë njerëzit. Ndohet këtu për të na kujtuar stacionet hekurudhore që u ngajnë stacioneve të jetës, me historitë dhe emocionet që përbëjnë thelbin e shpirtit shqiptar, dashurisë që mbajti gjallë familjet, e largësitë që kjo lokomotivë i shkurttoi. Ky rrugëtim përfaqëson sakrificat e pafundme të atyre njerëzve që derdhën djersë dhe mund për të vënë në lëvizje avulloret, që ndërtuan me devotshmëri rrugët e bashkimit me njëri-tjetrin dhe arritën asokohe të mbajnë gjallë fantazinë e çdo fëmije.

Cilët janë personat që shërbyen si ideatorë të parë të projektit?

"Hemingway Fun Club", ku bëj pjesë edhe unë së bashku me 2 vëllezërit e mi Rudi dhe Blendi. Gjyshi im ka qenë një ndër ata persona që kanë marrë pjesë në

Kjo ide është gati prej 3 vitesh dhe para 2 vitesh e kemi paraqitur në Bashkinë e Tiranës, që u mirëprit si ide. Pasi folëm me kryebashkiakun Erion Veliaj, ai e miratoi projektin dhe na dha hapësirën që ta vinim në jetë.

ndërtimin e hekurudhës së parë shqiptare në vitin 1947, linja Shkodër-Podgoricë. Kjo ishte një ndër lidhjet e largëta që na bëri të zgjidhnim sërish këtë lokomotivë, që prej 1986-ës rrinte në oborrin e oficinës së lokomotivave në Shkozë të Durrësit. Pra, gëzimi i njerëzve nga udhëtimi me tren përgjatë

maratonës së "swing"-ut, lidhja e largët e punës me hekurudhën shqiptare nga gjyshi jonë, memoria kolektive e kësaj lokomotive e në të njëjtën kohë e hekurudhës shqiptare ndër vite na dha shumë forcë të ecim para me një sfidë që ishte shumë e madhe për ne. Kjo është pjesë e historisë së familjeve shqiptare dhe në këmbëngulëm që kjo mos të harrohej.

Sa i vështirë ishte për ju finalizimi i projektit? A jeni financiar nga donjë institucion?

Ka qenë një sfidë e jashtëzakonshme për ne, shumë e vështirë, por ia dolëm! Pa harruar falënderimet për Ministrinë e Infrastrukturrës dhe Transporteve, Drejtorinë e Hekurudhës në Durrës si dhe Bashkinë e Tiranës, pasi u treguan të gatshëm që kjo lokomotivë të vinte në Tiranë, e mbështetën idenë. Ne e kemi mbuluar totalisht me financat tona të gjithë këtë proces pune, pra shpenzimet janë mbuluar nga "Heming-

way Fun Club". **Çfarë përfaqëson "Hemingway Fun Club"?** "Hemingway Fun Club" përfaqëson një jetë të thjeshtë, mbledh rreth vetes njerëz që kërkojnë të shohin jetën ashtu siç është realiteti dhe rikthimin e gjërave të bukura. Mendohej të promovojmë muzikën xhaz, në tërë format e saj. Deri më sot që flasim kemi organizuar 6 edicione të "Hemingway-JazzFest" në Tiranë dhe 3 edicione të "Swing Marathon" nga Tirana në Shkodër. Pa llogaritur një pafundësi minikoncertesh vetëm të këtij zhanri muzikor. Por, ne na pëlqejnë gjithmonë risitë e këtë vit zhvilluam një event që titullohej "Një ballo me maska", që u prit shkëlqyeshëm nga publiku ynë. Gjithashtu, organizojmë edhe mbremje poetike gjatë gjithë vitit, takime me shkrimtarë të rinj e të moshuar. Ne tregojmë dëshirën për një jetë ndryshe nga çka paraqitet në përditshmëri.

KREDITË E BUTA PËRFITUESIT

Voltiza Duro

Të gjithë qytetarët që janë shpallur fitues në fazën e parë të aplikimit për kreditë e buta në kryeqytet kanë mundësinë të dorëzojnë dokumentacionin e vlefshëm deri në 17 gusht të këtij viti. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot vendimin e Bashkisë së Tiranës mbi fazën e dytë të programit social "Subvencionimi i interesave të kredisë". "Fituesit e fazës së parë duhet të dorëzojnë dokumentet nga data 16.07.2018 deri më 17.08.2018 pranë sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët në Bashkinë Tiranë", theksohet në njoftim. Kështu, qytetarët aplikues duhet të tregojnë shumë kujdes, pasi nëse nuk dorëzojnë dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar, humbasin mundësinë për të fituar shtëpinë me kredi të butë. Bashkia e Tiranës bën me dije se nuk do të ketë një fazë tjetër për dorëzimin apo pranimin e dokumentacionit.

PËRFITUESIT

Ky program u vjen në ndihmë të gjitha çifteve të reja, të cilat kanë një nivel të caktuar të ardhurash nga punësimi dhe dëshirojnë të blejnë një shtëpi, por e kanë të pamundur të përfitojnë një kredi me kushtet e tregut. Kështu, Bashkia e Tiranës u subvencionon interesat e kredisë. Për të përfituar nga programi i "Subvencionimit të Interesave të Kredisë", aplikuesit duhet të plotësojnë disa kriteret, ku më kryesoret janë: Familjet që zotërojnë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar, individët të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjeç, familjet të cilat në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë si dhe familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit.

DOKUMENTET E PLOTA

Këtë vit janë plot 500 qytetarë që do të shpallen fitues dhe do të përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë". Personat që kaluan fazën e parë duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Pritjes me Qytetarin në Bashkinë e Tiranës dokumentacionin e nevojshëm që vërteton deklarimin dhe vërtetësinë e plotësimin të formularit të strehimit, në bazë të të cilit janë përgjedor fitues. Respektivisht kandidatët duhet të dorëzojnë: formularin e strehimit, certifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare,

Tabela/ Dokumentet e plota që duhet të paraqesin fituesit e fazës së parë

Shtëpitë me kredi të butë, afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit

Bashkia e Tiranës: Kujdes, nuk ka fazë tjetër pranimi

PARALAJMËRIMI

Qytetarët aplikues duhet të tregojnë shumë kujdes, pasi nëse nuk dorëzojnë dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar, humbasin mundësinë për të fituar shtëpinë me kredi të butë. Bashkia e Tiranës bën me dije se nuk do të ketë një fazë tjetër për dorëzimin apo pranimin e dokumentacionit.



FITUESIT E FAZËS I

Personat që kaluan fazën e parë duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Pritjes me Qytetarin në Bashkinë e Tiranës dokumentacionin e nevojshëm që vërteton deklarimin dhe vërtetësinë e plotësimin të formularit të strehimit, në bazë të të cilit janë përgjedor fitues.

17

GUSHT, AFATI I FUNDIT

Të gjithë qytetarët që janë shpallur fitues në fazën e parë të aplikimit për kreditë e buta në kryeqytet kanë mundësinë të dorëzojnë dokumentacionin e vlefshëm deri në 17 gusht të këtij viti.

vërtetimi të vendbanimit në bashkinë ku kërkohet vendstrehimi, vërtetimi i të ardhurave neto të familjes apo individit, vërtetimin e punësimit si dhe dokumentin për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë anëtarët e punësuar në familje. Gjithashtu, aplikantët duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pritjes me Qytetarin në Bashkinë e Tiranës edhe vërtetimin nga Zyra e Ndihmës dhe Përkujdesjes, vërtetim nga Zyra e Punës për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë, vërtetim

DOKUMENTACIONI QË DUHET DORËZUAR:

- Formulari i Strehimit i plotësuar pranë njësisë administrative në të cilën aplikanti ka vendbanimin.
- Certifikata e lindjes e aplikantit dhe certifikata e gjendjes familjare.
- Vërtetimi i vendbanimit në bashkinë ku kërkohet vendstrehimi, ose leje banimi për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.
- Vërtetimi i të ardhurave neto të familjes/individit.
- Dokumenti përkatës nga punëdhënësi (vërtetim punësimi), për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit dhe të personave të tjerë të familjes që janë në marrëdhënie pune.
- Dokumenti nga organet tatimore dhe nga sigurimet shoqërore për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë anëtarët e punësuar në familje.
- Vërtetimi nga Zyra e Ndihmës dhe Përkujdesjes pranë njësisë të qeverisjes vendore për anëtarët, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuara.
- Vërtetimi nga Zyra e Punës e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë.
- Vërtetimi nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.
- Dokumenti zyrtar i celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja.
- Vërtetimi nga ZRPP se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis që mund të përdoret si e tillë.
- Vërtetimi nga ZRPP për sipërfaqen e pronës që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi për strehim.
- Vërtetimi nga ZRPP të origjinës së nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi, për të gjithë anëtarët e familjes.
- Vendimi i gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara, shoqëruar me vërtetimin nga zyra e përmbartimit për masën e pensionit që përfitojnë për fëmijët.
- Vërtetimi përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit.
- Vërtetimi nga komisioni mjekësor për përcaktimin e aftësisë së kufizuara, për individë me aftësi të kufizuara.
- Dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe azilkërkues.
- Dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjëseve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Policisë së Burgjeve etj.
- Dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse për viktimat e dhunës në familje. Urdhri i mbrojtjes i lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor, seksioni familjar (fotokopje e njehsur me origjinalin). Vërtetim nga strukturat e shërbimit social, qendrave sociale dhe rehabilitimit për viktimat e dhunës pranë njësive të qeverisjes vendore.
- Deklaratë materiale që lëshohet nga kryefamiljari, i cili shprehet se është dakord që kredia të lëvrohet për aplikantin që rezultojnë i përfshirë në formularin e strehimit.

nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension, dokumentin zyrtar të celebrimit dhe certifikatat personale, vërtetim nga ZRPP se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis që mund të përdoret si e tillë, vërtetim nga ZRPP për sipërfaqen e pronës që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, vërtetim nga ZRPP të origjinës së nuk figuron e regjistruar asnjë pronë; vendimin e gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara. Ndërkohe, qytetarët duhet të dorëzojnë edhe një vërtetim për librezën e jetimit për individët me këtë status, vërtetim nga komisioni mjekësor për përcaktimin e aftësisë së kufizuara; për individë me aftësi të kufizuara; dokument për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe azilkërkues; dokument për familjet e punonjëseve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Policisë së Burgjeve etj.; dokument për viktimat e dhunës në familje si dhe një deklaratë materiale që lëshohet nga kryefamiljari, që shprehet se është dakord që kredia të lëvrohet për aplikantin që rezultojnë i përfshirë në formularin e strehimit.

ITALI - Sërish para të padeklaruar drejt Shqipërisë. Kësaj radhe zyrtarët e Agjencisë së Doganave në Bari në bashkëpunim me Guardia di Finanza kanë zbuluar 156.151 euro të padeklaruar në aeroport. Bëhet fjalë për shtatë përpjekje për eksport të paligjshëm nga dy qytetare nga Kosova, një serb, një gjerman e një shqiptar. Të gjithë këta persona po niseshin nga Bari për në Shqipëri, përveç dy të



Mediat italiane: Paratë po niseshin drejt Shqipërisë

Sekuestrohen mbi 150 mijë euro të padeklaruar në aeroportin e Barit, arrestohen 7 persona

tjerëve, një italiani dhe një gjermani. Mësohet se katër përpjekje të tjera për importim të paligjshëm, kishin të bënin me qytetarë të kombësive të ndryshme (kinez, ukrainas dhe katarian). Të gjithë shkelësit kanë për-

dorur të drejtën për të bërë një pagesë të menjëhershme që lejon që shkelja të zgjidhet duke paguar një shumë të caktuar për shumën që tejkalon kufirin e lejuar prej 10.000 euro. Më 23 qershor të këtij viti, në portin e Durrësit

u bllokuan rreth 3,5 milionë euro të padeklaruar. Paratë ishin fshehur në dy makina tip "Toyota Yaris" dhe sipas hetimeve kishin mbërritur nga Ankona. Në lidhje me këtë ngjarjeje u arrestuan katër persona.

Familjarët akuzojnë kompaninë e lundrimit: Do të bëjmë denoncim

Humb jetën në traget 58-vjeçari, pasagjerët: S'i dhanë ndihmën e parë

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Një 58-vjeçar, i cili ish te nisur drejt Durrësit për të kaluar pushimet verore ka ndërruar jetë në orët e para të mëngjesit të djeshëm teksa po udhëtonte me traget nga Bari. Bëhet fjalë për Isa Koni nga Maminasi, emigrant prej 20 vitesh në Itali. Mësohet se gjatë udhëtimit, Koni është ndjerë keq dhe ka kërkuar ndihmë, por nuk është i është dhënë nga stafi i tragetit. Pak minuta më pas ka ndërruar jetë. "Ai kërkonte ndihmë i shkretë, ishte keq, por në traget nuk kishte staf mjekësor", kanë thënë pasagjerët e tjerë që po udhëtonin në linjën Bari-Durrës. Ndërkohë, burime zyrtare nga policia e qytetit bregdetar bënë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 03:00. Grupi hetimor në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ekspertët e fushës po punojnë për përcaktimin e shkakut të vdekjes. Duke pyetur pasagjerët e tjerë, të afërmit kanë mundur të



58-vjeçari Isa Koni

rindërtojnë ngjarjen e të mësojnë çfarë ka ndodhur. Nisur nga dëshmitë, ata akuzojnë ekuipazhin e tragetit që nuk i ka dhënë ndihmën e duhur 58-vjeçarit.

DËSHMIA E TË AFËRMIT

Eldi Shehi, i afërm i viktimitës tha dje për "Gazeta Shqiptare" se Isa Koni është ndjerë keq dhe për rreth 1 orë



Eldi Shehi, duke folur për "Gazeta Shqiptare"

dhe se njerëzit pranë tij kanë kërkuar ndihmë, por askush nuk ka ardhur. "Ngjarja ka ndodhur kur ai ka qenë duke udhëtuar nga Italia për në Durrës me tragetin. Gjithçka e kemi marrë vesh vetëm nga pjesëtarët e tragetit. Asnjë mjek në bord. Vetëm nga udhëtarët çfarë kemi pyetur dhe shoferët e autobusëve çfarë na kanë thënë. Duam të themi që nuk i është dhënë ndihma e parë. Të gjithë thonë që personi ka qenë i shtrirë dhe zemra i pulsonte akoma. Për afro një orë pasagjerët kanë kërkuar që të shkonte një mjek apo infermier; po nuk ka qenë asnjë në bord. Ka kërkuar ndihmë, sepse mund të ketë pasur dhe shumë fluks dhe i është marrë fryma", u shpreh Shehi. Të afërmit e 58-vjeçarit akuzojnë kompaninë e lund-

HETIMI

Grupi hetimor në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ekspertët e fushës po punojnë për përcaktimin e shkakut të vdekjes. Këto ditë, numri i udhëtarëve që lëvizin me tragete mes dy brigjeve të Adriatikut është mjaft i lartë, për shkak të kthimit të mjaft emigrantëve për pushime në atdhe.

drim për mosdhënien e ndihmës së parë dhe për këtë pohojnë se do t'u drejtohen organeve kompetente. "Nëse nuk bëhet asgjë nga pala, do bëjmë denoncim nga të gjitha anët, do merremi me gjyqe me kompaninë", u shpreh i afërmi i viktimitës.

SHKURT

Sekuestrohen 130 kg marijuanë, pranga shqiptarit në Kostur

GREQI - Rreth 130 kg marijuanë janë sekuestruar dje në kufirin greko-shqiptar. Droga u gjet nga policia greke në një zone pyjore në Kostur. Policia ka zbuluar të fshehura në pyll 6 çanta dhe një thes, që përmbanin 29 pako me peshë totale 129 kg e 970 gramë marijuanë. Pranë tyre është arrestuar një shqiptar 27-vjeçar, i cili ruante zonën ku ishte fshehur droga. Në momentin e arrestimit, atij iu gjet dhe sekuestrua një celular me një kartë SIM. Prej fillimit të vitit e deri më sot, në Igumenicë, Korfuz, Lefkadhë, Kefalonia, Janinë, Athinë, Selanik, Arte, Kostur, Grevena, e Follorinë, policia greke ka sekuestruar rreth 6.7 tonë marijuanë që vinte nga Shqipëria. Dy javët e fundit ka pasur intensifikim të trafikut të drogës nga Shqipëria në Greqi në rrugë tokësore e detare.

Arrestohet 43-vjeçari nga Tirana, vidente portofola në Vlorë

Policia e Vlorës ka vënë në pranga një 43-vjeçar nga Tirana, i cili ishte specialist në vjedhjen e portofolave. Bëhet fjalë për shtetasin Roland B., i cili bënte namën në qytetin bregdetar në vjedhje portofolash. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Vlorës pohuan se kanë dokumentuar të paktën tetë vjedhje të kryera nga 43-vjeçari gjatë periudhës qershor 2017-korrik 2018. Sipas specialistëve të seksionit për hetimin e krimeve në Komisarriatin e Policisë Vlorë, Roland B. (person me precedent të mëparshëm penal në fushën e vjedhjeve) u vu në pranga gjatë operacionit të koduar "Portofoli". Materialet hetimore në ngarkim të tij iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për veprën penale "Vjedhja". Ndërkohë, pritet që gjykata të vendosë masën e sigurisë ndaj 43-vjeçarit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

PROCEDURE PROKURIMI

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Procedurë e veçantë sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 65, datë 26.11.2014, i ndryshuar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 17.500.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halil", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 06 Shtator 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON"
me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA

Dt. 08.08.2018 ora 16:00
Përfundon Ankandi i Parë për pasurinë:

- Pasuria "Trulli+Ndërtëse" me sip.529.25 m2, me adresë Sallimone, Durrës. Me çmim 40 000 Euro
- Pasuria "Arë" me sip.3750 m2, me adresë Hardhishtë, Durrës. Me çmim 22 400 Euro

Ankandi Zvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma Iliria), Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBA

Nr. 621

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

E shtunë 4 Gusht 2018


Zbulohet çifti i ri i
'showbizz'-it shqiptar

**PUSHIMET E ËMBLA TË
KENGËTARES DHE ARBRI
NË JUG TË VENDIT**



**ADELINA
BERISHA,
HISTORË
ME DJALIN
E DEPUTETIT
LETER KOKA**

LIDHJA SEKRETE



VIP-a NE PLAZH

ANA DEL TOPLESS. EINXHEL POZON SEKSI. AURELA
SENSUALE. BEATRIX RAMOSAJ NË SUPERFORMË



EVA MURATI:

**SE SHPEJTI NIS
XHIRIMET PER
NJE FILM TE RI**

Kush është Luana në të vërtetë? Bukuroshja "nxjerr" sekretin në "Instagram"

Pas lançimit të dy këngëve më të reja për këtë verë, "Mi dhe zjarr mallit tim" dhe "Vetëm ty", Luana Vjollca është duke bërë turin e saj të këngëve në Maqedoni e Kosovë. Ndërkohë që në postimin e saj të fundit tërhoqi vëmendjen me një detaj të veçantë, të cilin nuk e kishte shfaqur më parë. Edhe pse të gjithë e njohin si moderatorja e dhe këngëtarja seksi, ajo shfaqet edhe si një vajzë çapkëne. Kjo vihet re pikërisht në videon e fundit të postuar në "Instagram". Edhe pse seksi dhe me një makeup bombastik, Luana i rikthehet videos duke nxjerrë gjuhën. "Kjo jam unë në të vërtetë", shkruan ajo poshtë videos. Ja dhe Luana e vërtetë, çapkëne, seksi dhe lozonjare.




Adelina në muajin e fundit të shtatzënisë, poston foton para lindjes

Tashmë ajo ka hyrë në muajin e nëntë të shtatzënisë dhe tani pritet që nga momenti në moment të sjellë në jetë fëmijën e saj të parë. Këngëtarja e njohur, Adelina Tahiri, ka postuar së fundmi një foto ku shfaqet e lumtur me barkun e rumbullakosur në një foto bardh e zi. Në kemi arritur të kuptojmë se djali që do të vijë në jetë do t'i nisë emri me J dhe se mami dhe babi po e presin me padurim ashtu si dhe gjithë prindërit e tjerë që janë në një pritje të ëmbël. Me siguri do t'i ngjajë bukuroshes me sytë e mëdhenj blu dhe me një buzëqeshje engjëjllore. Mezi presim ta shohim!






E fiksuar pas tatuazheve, Dafina Zeqiri provokon duke dalë nudo

Nuk është diçka e re fiksimi që ka këngëtarja e dashur për publikun, Dafina Zeqiri për tatuazhet. Gjithashtu, e dimë tashmë se asaj i pëlqen të provokojë në mënyra të ndryshme nëpërmjet postimeve në "Instagram". Kësaj radhe, këngëtarja ka tërhequr vëmendjen duke postuar në "Instastoy" një video ku shfaqet pa të brendshme dhe në profil duke treguar tatuazhin e saj më të ri të bërë në kofshën e djathtë. Një trio gjarpërinjsh i është shtuar koleksionit të tatuazheve në trupin e Dafit. Të shohim cili do të jetë i radhës dhe si do ta reklamojë ajo atë.






Zbulohet çifti i ri i 'showbizz'-it shqiptar



Adelina Berisha, e lidhur me djalin e deputetit Lefter Koka



Pushimet e ëmbla të këngëtares dhe Arbrit në jug të vendit

Egla Xhemali

Ajo është një ndër këngëtares më popullore, ndërsa ai ndër beqarët më të kërkuar të vendit tonë. Mesa duket, një tjetër histori dashurie ka lindur në radhët e VIP-ave, që deri më sot është ruajtur me fanatizëm dhe larg syrit të publikut. Po flasim për këngëtares kosovare, Adelina Berisha dhe dja-

lin e deputetit të Durrësit, Lefter Koka, Arbri. "Bluetooth" ka mundur të mësojë se dyshja është në një lidhje dashurie prej pak kohësh. Arbri dhe Adelina janë takuar në vendin tonë nga shoqëria e përbashkët, e duket se nga ajo ditë, ata po kalojnë përherë e më shumë kohë në shoqërinë e njëri-tjetrit, tashmë si dy të dashuruar. Mes angazhimeve të shumta që Adelina ka në sezonin e verës, ajo

gjen kohë të udhëtojë drejt Durrësit për të takuar të dashurin e saj të ri. Me aq sa kemi mundur të marrim vesh edhe nga miqtë e çiftit, nuk kanë qenë të pakta edhe rastet kur Arbri ka udhëtuar drejt Prishtinës për të qenë më pranë partneres së tij. "Bluetooth" ka mundur të mësojë edhe për 'arratisjen' e ëmbël të çiftit këtë verë në jug të vendit tonë. Arbri dhe Adelina janë shfaqur më të dashu-

ruar se kurrë në bregdetin e Jalës. Çifti ka zgjedhur të pushojë për pak ditë në një nga resortet e bregdetit, duke bërë kështu një nga daljet e tyre të para së bashku. Edhe pse shpesh janë përpjekur t'i shpëtojnë syrit të publikut, në rrethin e tyre të miqësisë, kjo lidhje është mjaft popullore. Arbri Koka është djaloshti simpatik i deputetit të Durrësit, Lefter Koka. Djaloshti është i njohur

për angazhimin e tij në politikë, duke qenë pjesë e strukturave të LSI. Por nga ana tjetër, të gjithë e njohin Arbrin si djaloshti simpatik, të preferuarin e femrave. Adelina Berisha është këngëtarja që prej vitesh ka mbetur e preferuara e publikut. Biondja seksi konfirmon në çdo dalje të saj që mbetet një ndër femrat më sharmante. Por ajo që është edhe më e veçantë për Adelinën është se kurrë më parë, ajo nuk është përfolur për një histori dashurie. Në intervistat e dhëna më herët, këngëtarja shpesh shprehej se nuk kishte qenë kurrë në një lidhje apo e dashuruar. Mesa duket tek Arbri, Adelina paska gjetur dashurinë e vërtetë. Mbetet për t'u parë sesi do të shkojë historia për këtë çift që tashmë janë në fillimet e marrëdhënies. E derisa të dy ta pranojnë vetë këtë lidhje, mediat rozë do të jenë më të vëmendshme për të zbuluar detaje nga kjo histori dashurie.

VIP-a në plazh

Provokim apo trend? Ana del topless në rrjetet sociale. Einxhel Shkira pozon më seksi se kurrë në Greqi

Edhe një muaj i nxehtë na ka mbetur për këtë verë dhe ne do të përfitojmë nga rasti për të paraqitur destinacionet e preferuara të VIP-ave tanë për pushime nëpër vende të ndryshme të botës. Kush në Itali, kush në Turqi apo të tjerë edhe në vendlindje, edhe pse në ditë relaksi, nuk kanë qëndruar dot pa na treguar se si po i kalojnë momentet e tyre të pushimeve. Ne kemi zgjedhur vetëm disa prej tyre, këtë herë duke veçuar ata që kanë qenë edhe më tepër aktivë në rrjetet sociale. Për më tepër ndiqni renditjen e mëposhtme:

Nga Pamela Aliaj

Fotot provokuese të femrave seksi buzë detit

Provokim apo trend? Ana del topless në rrjetet sociale

Nuk është hera e parë që aktorja e njohur, Anais Lika, provokon me postimet e saj në rrjetet sociale. Kësaj radhe, ajo ka preferuar që përveçse të postojë foto me thënie të cilat të bëjnë të mendosh se kujt i dedikohen, hedh foto që nuk kanë aspak nevojë për fjalë. Një foto e fundit e hedhur në "Instagram" shfaq Anën topless, duke mbuluar gjoksin me dy feta shalqiri. Të jetë kjo një nga mënyrat e saj për të tërhequr vëmendje, apo thjesht për të ndjekur trendin e momentit?! Gjithsesi, komentet e ndjekësve nuk kanë qenë të pakta, duke treguar mospëlqimin e një provokimi të tillë të quajtur kështu nga ata.




Si një italiane e vërtetë, Aurela Hoxha shfaqet sensuale me bikini

A të e shohim kudo duke udhëtuar në destinacionet më të lakmuara këtë verë për të kaluar pushimet. Pasi lançoi në treg linjën e saj të kostumeve të banjos, tashmë bukurshja Aurela Hoxha është duke shijuar ditët e saj të relaksit në Itali. E shfaqur më seksi se kurrë me rroba banjo të bardha dhe me një hije prej latineje, Aurela duket se po i shijon në maksimum këtë verë.

I vuri "flakët" Mikonosit, Einxhel Shkira pozon më seksi se kurrë në Greqi

Edhe pse është shkëputur për një kohë nga media, Einxhel Shkira vijon të jetë në qendër të vëmendjes së mediave rozë. Nuk është hera e parë që ajo së bashku me grupin e shoqeve të pandara shijojnë pushimet në vende të ndryshme të Europës. Këtë herë, destinacion i pushimeve të saj është Mikonosi i Greqisë, ku ajo së bashku me shoqen e saj janë duke shijuar momente të paharrueshme. Këtë e vërtetojnë edhe postimet e herëpashershme, që Einxhel bën nëpër rrjetet sociale duke u shfaqur në një formë fantastike dhe superseksi.




Nga Turqia në Shqipëri, ja destinacioni i radhës i Ilda Bejlerit këtë verë

Pas përfundimit të Botërorit të "Rusi 2018", bukuroshja Ilda Bejleri nisi sezonin e pushimeve duke zgjedhur si destinacion të parë Turqinë. Por ndërkohë ajo është rikthyer në Shqipëri, ku ashtu si shumë VIP-a të tjerë ka preferuar të kalojë disa ditë relaksi në jug të vendit e aktualisht në Dhërmi. Nuk ka se si të jetë ndryshe jo vetëm për Ildën, por edhe për shumë të tjerë që nuk mund të mos shijojnë mrekullitë e vendit që i ofron vetëm bregdeti jonian.

VIP-a në plazh

'Sirenat' zbresin në breg, Beatrix Ramosaj duket në superformë në brigjet e detit Jon

Një tjetër VIP ka vendosur të kalojë momente të bukura të pushimeve në jug të Shqipërisë. E kemi fjalën pikërisht për këngëtarën bukuroshe, Beatrix Ramosaj, e cila së bashku me vëllain e saj po shijojnë pushimet në Drimadhes të jugut të vendit. Mesa duket, nga fotoja e postuar së fundmi, edhe Trixa ka arritur ruajtje forma fantastike për këtë verë duke u shfaqur si një sirenë e vërtetë në breg të detit Jon.



Afrikë, Itali dhe më në fund ja ku i shijon pushimet kësaj radhe Alketa Vejsiu

Pas një sezoni të ngjeshur televiziv, Alketa Vejsiu nisi që në muajin qershor pushimet, të cilat mesa duket do të zgjasin gjithë verën. Duke e nisur sagën nga Afrika e Jugut e duke shfaqur foto e video nga eksperiencia e veçantë e kaluar së bashku me vajzën e Vera Grabockës, kësaj radhe Alketa ka zgjedhur t'i rikthehet vendlindjes për të shijuar disa ditë detin e jugut të Shqipërisë. Nëpërmjet një fotoje në "Instagram", Alketa shfaqet e relaksuar në Dhërmi të Vlorës, duke shijuar diellin e kësaj vere të nxehtë. Diell, det dhe relaks. E pse jo? Një shtator i ngjeshur me siguri po e pret, kështu që deri atëherë Alketa do të jetë 'offline'.

RRËFEHET MODERATORJA: KAM RËNË NË DASHURI ME CHAMPIONS LEAGUE

EVA MURATI:

Pas valës së gjatë të emocioneve që la pas Botërori i "Rusi 2018", nuk kishin si të mos viheshin në pah edhe bukuroshet, të cilat e transmetuan atë për një muaj me radhë në ekranet shqiptare. Ajo është pikërisht njëra prej tyre, e cila spikati jo vetëm me thjeshtësinë dhe zotësinë e saj, por gjithashtu edhe me sharmin e emocionin që transmetoi çdo natë 'live' për muajin e Botërorit. Duhet të theksojmë se jashtë kuintave të kamerës, ajo është shumë e rezervuar për jetën e saj dhe aspiratat që ka për të ardhmen. Por në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Eva Murati, tashmë ikona e "Tring Sport", ka folur për prapaskenat e jetës së saj dhe jo vetëm. Aspiratat që ka për të ardhmen, planet për një film të ri, ku ajo do të jetë pjesë si dhe shumë e shumë gjëra të tjera i gjeini në intervistën e mëposhtme.

Pamela Aliaj

Si kaloi ky Botëror për ju? Cili ishte momenti që do të veçonit?

Kampionati Botëror është një kompeticion që vjen njëherë në 4 vjet plot energji dhe hare për të na argëtuar, Padyshim që ka pasur shumë momente të bukura, çaste që na kanë emocionuar shumë, sepse ky mbi të gjitha është quajtur Botërori i surprizave, pasi shumë pak ndeshje kanë përfunduar "si në letër", por kanë qenë jashtë çdo parashikimi. Midis tyre do të veçoja golat e bërë nga Shaqiri dhe Xhaka, dy lojtarët zviceranë me origjinë shqiptare në ndeshjen kundër Serbisë. Ka qenë një moment i jashtëzakonshëm e që për ne i kapërceu kufijtë e futbollit dhe na dha shumë emocione të përziera së bashku: lumturi, krenari, ankth, tronditje. Kjo ka qenë një fitore e madhe për ne si shqiptarë, prandaj e veçoj mbi të tjerat.

Pas një muaji kaq të ngjeshur padyshim keni nevojë për pushime relaksuese. Ku do zgjidhni t'i kaloni ato?



Ky muaj që kaloi me është dukur tepër i gjatë, sepse angazhimi për Botërorin ishte i madh, por pavarësisht kësaj, ende nuk mund të nisem me pushime. Tani jam me sezon provimesh dhe pastaj nis me xhirimet e një filmi të ri. Mbasi t'i mbyll të gjitha këto, do nis zyrtarisht pushimet verore. Shpresoj të ketë mbetur ende kohë, sepse Super Kupa më 15 gusht shënon edhe hapjen e sezonit futbollistik me vazhdimin e Champions League. Ky është plani i çdo vere, pasi kryesisht produksionet filmike zhvillohen në këtë stinë. Do të më duhet të pres edhe pak për pushime, për të provuar relaksin aq shumë të dëshiruara që të ofrojnë pushimet, por nuk mërzitem, kënaqësia që ndjen mbasi del produkti për-

fundimtar është çlodhja më e madhe.

Shumë nga imazhet e ekranit do të lëvizin duke nisur një sfidë të re këtë shtator për në media të reja. Po për Evën do të ketë ndryshime?

Dikush përpiqet të gjejë diçka më të mirë, dikush nuk është i stabilizuar, moritë e arsyeve pse ka pasur dhe kaq shumë lëvizje, kaq të "çuditshme" janë nga më të ndryshmet. Për t'u treguar e sinqertë, këtë vit kam pasur oferta jashtëzakonisht tunduëse dhe jam e lumtur për këtë. Askush nuk të kërkon nëse nuk je aset për median që zotëron, prandaj jam e kënaqur që puna ime është vlerësuar. Sa për vitin e ardhshëm, nuk do të ketë

Së shpejti nis xhirimet për një film të ri

"Ka shumë maska të vendosura, sa mendoj se është harruar edhe fytyra e vërtetë"

ndryshime. Jam lumtur me bashkëpunimin me "Tring" dhe kam rënë në dashuri me Champions League. Është bërë pjesë e imja tashmë. Gjithashtu është një emision që më jep kohën e mjaftueshme për t'u marrë me shkollën dhe projektet filmike, prandaj mendoj se peshorja është goxha e balancuar dhe nuk ka pasur nevojë për ndryshim.

Ju kemi parë prej kohësh të jeni pjesë e moderatorit të emisioneve sportive. E zgjodhët ju këtë zhanër, apo ju zgjodhi?

Nëse do të më kishit thënë

para 2 vitesh që do të prezantoja emisione sportive, nuk do ta kisha besuar kurrë. Nuk mendoja se do isha ndonjëherë pjesë e tyre për shkak të seriotipit të shpeshtë që karakterizon prezantueset sportive. Nuk më lidhte asgjë me futbollin, përveçse ndeshjeve të para me shokërinë, më tepër për të pirë diçka bashkërisht sesa për të ndjekur lojën. Tashmë është diçka krejt ndryshe. Mendoj se pranimi i prezantimit të Champions League është nga ato lloj projektesh që janë fat në karrierën e një prezantuesi. Padyshim që Champions më zgjodhi mua, në kohën kur erdhi kjo ofertë, prezantoja një emision me intervista me personazhe, ndërkohë pata edhe dy oferta të tjera, për shkak se ishte ndërërim i sezonit televiziv dhe ishte çast lëvizjesh të mëdha, sikurse edhe tani. Disa miq të mi, fanatikë futbollit këmbëngulën me tezën se Champions është Hollivudi i futbollit dhe do isha e marrë, nëse do ta refuzoja. Për të thënë të vërtetën, tani që ka kaluar kohë, mendoj ishte një ofertë e ardhur në tempizëm perfekt, emisioni i duhur në kohën e duhur.

Cila lloj hapësire media-tike do t'ju joshite për të punuar?

Padyshim që spektaklet argëtues "entertainment show" janë ato ku e ndej veten më mirë, pasi janë një ndërthurje e disa zhanreve. I rikthehem herë pas here përg-



jatë vitit 'show'-ve të tillë me projekte të ndryshme të shkurtra. Mendoj se në një të ardhme do t'ju kthehem sërish, por tani për tani jam e lumtur me projektet që kam.

Jeni vetëm 23 vjeçe dhe në kulmin e karrierës, apo prisni të arrini diçka më tepër? Cila është maja për ju?

Ndonjëherë do doja që të kthehesha pas në kohë dhe t'i thosha Evës 15-vjeçare të mos shqetësohej aq shumë se gjërat do ecin mirë. Kam punuar shumë, nuk jam kënaqur asnjëherë me atë që kam pasur dhe shpeshherë kam shkuar në ekstrem duke harruar çdo gjë tjetër përreth. Ndoshta tani duket diçka mëse e zakonshme kjo mënyrë, pasi të gjithë i përkushtohen karrierës që kanë zgjedhur, është mëse normale. Forca ime më e madhe ka qenë se kam arritur ta konstatoj këtë gjë në moshë shumë të re dhe për një 15-vjeçare të punuarit për karrierën që do të ketë në 5 vitet e ardhshme është goxha sfiduese. Gjithsesi, për ta lidhur edhe me botën e sportit, jam e lumtur që vlera e "kartonit" tim që nga ajo kohë është rritur. Jam me fat për këtë, shumë njerëz mundohen shumë dhe kurrë nuk shpërblehen. Jam e lumtur që munda dhe durimi im nuk ka shkuar dëm. Padyshim që oreksi vjen duke ngrënë dhe planet janë të shumta, por gjithsesi jam optimiste për atë që më pret në të ardhmen, sepse e kam provuar veten. Shpresoj që fati të më ndjekë siç ka ndodhur deri më tani.

Pasioni i fshehtë i Evës është..?

Jam e lumtur që pasionin tim për televizionin kam arritur ta kthej në profesion, pasione të tjera kam fotografinë dhe nuk po flas për të pozuar por për të qenë pas aparatit, si dhe leximi i romaneve, mundësisht në natyrë.

Nëse nuk do të zgjidhni të ishit moderatore, me çfarë do të merreshit si profesion?

Unë tashmë e kam bërë një zgjedhje në karrierë që nuk ka lidhje me fushën e artit. Pas mbarimit të programit bachelor në Universitetin Publik të Tiranës, në Fakultetin e Drejtësisë po vazhdoj vitin e parë master shkencor penal po në të njëjtin fakultet. Përpas kësaj, nëse nuk do të isha marrë me televizion që në adoleshencë, mendoj se do e kisha shprehur në të tjera mënyra dëshirën time për të folur në publik, me siguri do të kisha hapur një kanal në 'Youtube' (qesh).

A keni plane dasme se shpejti?

Sapo kam mbushur 23 vjeç, jam e lumtur me bekimet që më ka sjellë Zoti në jetë,



por dasma nuk është në planet e mija të afërta.

Lidhur me "incidentin" me ish-banoren e "Big Brother", a keni pasur kontakte më përpara se ta sqaronit 'live' në media më të? Pse u keqkuptua sipas jush?

Nuk do doja t'i shtoja apo t'i hiqja ndonjë presje asaj që thashë në TV në ballafaqimin në "Top Channel". Nuk do ta nisja aspak diskutimin nëse do e dija se vajza ishte e famshme, pasi përpiqem të ruhem nga lajme të tilla të pakuptimita portalesh. Reagimi im ndaj adresës false të trajnerit Klop erdhi për 2 arsye. E para, sepse koment ishte tepër sekssist, pra vajzat shqiptare i duhen Botërorit se janë joshëse dhe provokuese e nuk kanë asnjë vlerë tjetër, gjë që ka gjetur bazë të fortë edhe duke parë nismat ligjore të FIFA-s për gjobitjen e pamjeve të tilla tepër sekssiste. E dyta dhe më e rëndësishmja, sepse ishte një koment që e shumëzonte me zero të gjithë mundin dhe talentin e djemve që luajnë me Kombëtaren shqiptare. Kjo



është tepër e padrejtë, mbi të gjitha në një foto ku shfaqen simbolet kombëtare. Në rast se një sportist përfaqësues i shtetit amerikan dëmtohet, çështja shkon deri tek FBI, në rast se në një film amerikan shfaqet grisja apo përdhosja e flamurit, filmi refuzohet nga kinematë dhe regjisori futet në listën e zeze. Tifozët anglezë njihen në botë për çmenduritë që kanë bërë për skuadrën e tyre. Pse flamuri dhe simbolet e vendit tim duhet të përliften dhe unë të qëndroj pa bërë asgjë? Ndoshta unë nuk kam asgjë në dorë, por të paktën kam fuqinë e rrjeteve sociale, që është bërë faktike në shekullin ku jetojmë. Mendoj se është një çështje që nuk ia vlen më të diskutohet, prandaj e sqarova njëherë e mirë "live" në TV. Për ta përmbyllur, do thosha se golat e Shaqirit dhe Xhakës janë përgjigjja më e mirë që mund të jepej. Një vend kaq i vogël si yni ka nxjerrë mjaft talente, duhet trajnohen siç duhet dhe këtu çështja shkon përtej futbollit duke përmendur Rita Orën, Dua Lipën etj. Këto fjalë janë thjesht

tyra e vërtetë. Më e keqja se shpeshherë e bërë pa arsye, thjesht për të ushquar egon personale. Nuk është turp të gabosh, por të mos tregohesh i singhtë me të tjerët dhe mbi të gjitha, me veten! Ç'kuptim ka të gënjesht veten, duke jetuar në një botë iluzionesh që nuk ekzistojnë kur të tjerët e njohin realitetin tënd?

A jeni penduar për diçka të ndodhur dhe nëse po, ç'do të bënit për ta rregulluar nëse do ktheheshit pas?

Padyshim të gjithë kemi momentet tona të mërziisë dhe mbi të gjitha, të brengës duke menduar se çfarë mund të ndodhte në rast se do të kisha vepruar ndryshe... 'what if' (po sikur) na shoqëron gjithnjë sepse efekti flutur është më real se kurrë. Kam momente të tilla, sidomos në çaste dobësie, por përgjithësisht jam e lumtur mes gjërave kaotike që më kanë ndodhur në jetë, sepse rezultati të cilin e jetoj më pëlqen!



Opinion i Ditës

Marrëveshja historike e Mukjes

(75-vjetori i Kuvendit të Mukjes)

Nga Dr. Uran Butka

(vijon nga faqja 1)

...e Mukjes - shans i bashkimit, peng i tradhtisë", një marrëveshje kombëtare mes organizatës së Ballit Kombëtar dhe Këshillit të Përgjithshëm NÇ (1-3 gusht 1943). Në këtë botim të plotësuar me dokumente të rinj, jepen kushtet historike që imponuan marrëveshjen e Mukjes: Në një kapërcyell kohësh: në prag të kapitullimit të Italisë fashiste dhe të pushtimit gjerman të Shqipërisë; në një udhëkryq të historisë sonë: në prag të bashkimit kombëtar në luftën kundër okupatorëve, por edhe të ndarjes, të mosmarrëveshjes dhe të konfrontimit të madh brenda vetes, në një dualitet alternativash: nacionaliste apo komuniste, demokratike apo totalitariste, perëndimore apo lindore.

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, sidomos përgjatë vitit 1943, kudo, në çdo familje, fshat, qytet e krahinë të vendit, si edhe në diasporë, flitej e shkruhej për nevojën e domosdoshme të bashkimit të të gjithë shqiptarëve për të përballuar kushtet e rënda të pushtimit italian dhe veçanërisht, të bashkimit për të përballuar një pushtues tjetër më të egër, i cili kishte bërë daljen dhe goditjen e parë në Borovë, korrik 1943. Pra, në prag të mbledhjes së Mukjes, bashkimi ishte një kërkesë mbarëkombëtare, një imperativ i kohës.

Mirëpo, ndarja e madhe në dy grupe antagoniste të rezistencës shqiptare, ku përshihet gati i gjithë populli, e kishte brenda mundësinë e bashkimit të përspejtë, sidomos përballë pushtuesve nazifashistë, por e kishte brenda edhe rrezikun e konfliktit, sidomos përballë presionit sllavo-komunist; i kishte premisat objektive edhe për bashkëpunim, por edhe konfrontim midis tyre për pushtet, gjë që mund të sillte luftë civile. Përballë këtij rreziku të dyfishtë, e vetmja zgjidhje pozitive e shpëtimtare për Shqipërinë ishte bashkëpunimi midis dy grupeve më të mëdha politike e ushtarake në luftë kundër armiqve të përbashkët të Shqipërisë, por edhe më tej.

Këtë e realizoi Kuvendi i Mukjes. Ndryshimi i Marrëveshjes së Mukjes nga marrëveshjet e mëparshme të shqiptarëve qëndron në faktin se ato ishin përgjithësisht të njëzëshme, ndërsa Mukja bashkoi për interesat madhore dy krahë të ekstremë, madje armiqësorë, të mendësish dhe të politikës shqiptare: organizatën nacionaliste të Ballit Kombëtar dhe Lëvizjen Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga PKSH.

Ndryshimi tjetër është, që marrëveshja e Mukjes u imponua nga poshtë-lart, nga nevoja e kërkesa e vetë popullit për bashkim e luftë të përbashkët, gati në gjithë krahinën e Shqipërisë.

A mund të bashkoheshin dy të kundërtat, kur ishte në lojë interesi kombëtar?

Po. Së pari, sepse në këtë moment kritik bashkëpunimin e kërkonin të gjithë shqiptarët e ndershmë patriotë. Bashkimi ishte bërë nevojë e vullnet



i një kombi. Në mos në Mukje, diku tjetër do të kryhej ky akt madhor, i mbarsur në kohë. Duhej një luftë e përbashkët antifashiste dhe jo një luftë e pjesshme, partiake.

Së dyti, edhe situata ndërkombëtare në verën e vitit 1943 ishte më e favorshme. Koalicioni i madh antifashist po përparonte në luftën kundër nazifashizmit. Misionet aleate britanike kishin ardhur në Shqipëri dhe kishin kontaktuar si me Nacionalçlirimtarin, ashtu edhe me Ballin Kombëtar; kërkonin bashkëpunimin mes tyre në luftë kundër ushtrive të Boshtit dhe e mbështetnin atë.

Së treti, sepse të dyja grupimet kryesore të rezistencës antifashiste: organizata e Ballit Kombëtar dhe Këshilli i Përgjithshëm NÇ, e konsideronin okupatorin si armik, shkelës së sovranitetit dhe të pavarësisë së Shqipërisë dhe si i tillë ai duhej luftuar. Së katërti, deri në Mukje grupimet kryesore politike ende e konsideronin njëri-tjetrin si kundërshtarë politikë, por jo si armiq. Fakti që gjatë vitit 1943, ishin nënshkruar e arritur mjaft marrëveshje lokale dhe kërkohet me insistim nga populli dhe nga përfaqësuesit e të dy organizatave në bazë që ky mirëkuptim të vendosej edhe në qendër, fakti që deri në gusht të vitit 1943, çetat nacionaliste dhe ato partizane në përgjithësi nuk erdhën në përpjekje të armatosur midis tyre, madje zhvilluan mjaft beteja të përbashkëta si në Gjorm, Pocerest, Reç etj., vërtetoren frymën ekzistuese të mirëkuptimit e jo të konfrontimit mes shqiptarëve.

Së pesti, sepse zgjidhja e çështjes sonë kombëtare, doli si problem jetësor i kombit shqiptar, sidomos gjatë

Luftës së Dytë, kur ishte bërë e faktoto bashkimi i një pjesë të mirë të trevave të Shqipërisë Verilindore me shtetin amë. Kërkesa për vetëvendosjen e popullit të Kosovës sipas parimit të Kartës së Atlantikut u bë shprehje e vullnetit gjithë kombëtar; gjë që impononte e kapërcente edhe mospatimet politike të grupeve kryesore të rezistencës. Edhe përfaqësuesit e Këshillit të Përgjithshëm NÇL., në Mukje, megjithëse nuk e kishin në programin e tyre Shqipërinë etnike për arsye të tashme dihen nuk dolën kundër dëshirës e vullnetit gjithëshqiptar për një Shqipëri të bashkuar etnike dhe më në fund e pranuan këtë opsion. Në një letër të Miladin Popoviçit drejtuar Titos, në prag të Konferencës së Mukjes shkruhej ndër të tjera: "E tanë Shqipëria asht e okupueme prej këtij problemi".

Për këto arsye, marrëveshja e bashkëpunimi gjithëshqiptar ishin plotësisht të mundshme. Mukja po trokiste në dyert e historisë shqiptare, se e kërkonte koha. U bënë mjaft takime e konsultime paraprake ndërmjet eksponentëve kryesorë të të dy organizatave, por elementët kryesorë bashkues ishin Abaz Kupi nga Nacionalçlirimtarja dhe Ihsan Toptani nga nacionalistët. Dokumenti më i rëndësishëm në rrugën drejt Mukjes ishte, pa dyshim, ai i datës 18 korrik 1943, një mesazh i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar drejtuar Organizatës së Ballit Kombëtar; hartuar dhe firmosur nga Y.Dishnica, M.Gjinishi, A. Kupi dhe M.Peza, që shpreh parimet kryesore të Lëvizjes Nacionalçlirimtare mbi

të cilat u arrit edhe mirëkuptimi. Ky dokument i rëndësishëm nuk është botuar më parë dhe është heshtur qëllimisht, sepse këto parime demokratike, si: lufta antifashiste ku të marrin pjesë gjithë atdhetarët pa dallim feje, krahine dhe ideje; moscenimi i pronës dhe i iniciativës private, zgjedhje të lira e demokratike pas shpërrjes së pushtuesve, u shmangën më vonë.

Sipas procesverbalit të mbledhjes së Mukjes, të dyja organizatat u përfaqësuan nga këta delegatë:

Kryetarë delegacionesh ishin Mid'hat Frashëri dhe Ymer Dishnica. Kryetar i punimeve të Kuvendit

u zgjodh me propozim të Nacionalçlirimtares, Thoma Orologaj, delegatë i Ballit Kombëtar; ndërsa sekretar Mustafa Gjinishi i Nacionalçlirimtares.

Pas një debate prej tri ditësh, u arrit marrëveshja. Pika e parë e saj ishte krijimi i Komitetit "Për shpëtimin e Shqipërisë". Atributet e tij të rëndësishme, flasin për një zgjidhje të re politike, për një përgjegjësi, pjekuri dhe angazhim të madh kombëtar të forcave politike kryesore në Shqipëri. Ky ishte forumi i parë pluralist në Shqipëri, si forma më demokratike e qeverisjes së botës së qytetëruar: Kjo mënyrë organizimi do të shtrihet edhe në gjithë strukturat e bazës dhe do të unifikoje drejtimin, do të shmange anësinë partiake, do të eliminonte përçarjen e antagonizmin, do të mënjanonte rrezikun e luftës civile, do të bashkonte në një front të përbashkët të gjithë shqiptarët pavarësisht nga bindjet politike, nga përkatësia partiake, fetare, krahinore, në luftë të përbashkët kundër okupatorëve dhe do të çelte udhën e demokracisë së vërtetë pluraliste perëndimore.

Në proklamatinë e datës 3 gusht 1943, Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë, paraqiti këtë program:

1. Luftë të përbashkët dhe të menjëhershme përbi Aleatëve të mëdhenj Anglisë, SHBA dhe Bashkimit Sovjetik si edhe të popujve të shtypur kundra pushtuesit barbar, me divizion rilindasë "Ja vdekje, ja liri!"

2. Luftë për një Shqipëri të Pavarë, luftë për zbatimin e parimit të njoftuar botërisht e të garantuara nga Karta Atlantike të vetëvendosjes së popujve, për një Shqipëri etnike.

3. Luftë për një Shqipëri të lirë, demokratike e popullore. Komiteti për shpëtimin e Shqipërisë do të vazhdojë luftën tue udhëhequn popullin shqiptar në rrugën e sakrificës dhe të nderit deri në formimin e një qeverie provizore.

Forma e regjimit do të caktohet prej vetë popullit me anën e një Asamblejeje kushtetuese →

PERFAQESIMI I ORGANIZATAVE

Delegacioni i Ballit Kombëtar

1. Z. Av. Hasan Dosti
2. Z. Mid'hat Frashëri
3. Av. Thoma Orologaj
4. Av. Skënder Muço
5. Komandant Hysni Lepenica
6. Prof. Isuf Luzaj
7. Komandant Kadri Cakrani
8. Major Rauf Fratari
9. Prof. Nexhat Peshkëpia
10. Av. Halil Mëniku
11. Kom. Ismail Petrela
12. Prof. Vasil Andoni

Delegacioni i Këshillit të Përgjithshëm NÇ

1. Major Abaz Kupi
2. N. Kolonel Jahja çaçi
3. Kom. Myslim Peza
4. Dr. Ymer Dishnica
5. Z. Mustafa Gjinishi
6. Dr. Omer Nishani
7. Dr. Sulo Bogdo
8. Z. Stefan Plumbi
9. Z. Shefqet Beja
10. Z. Medar Shtylla
11. Z. Haki Stërmilli
12. Gogo Nushi



← versalidirekt." E veçanta e Kuvendit të Mukjes ishte trajtimi me përparësi dhe kompetencë të çështjes sonë kombëtare në krizë, veçanërisht i Kosovës. Në Mukje u bë përpjekja e parë institucionale për zgjidhjen e çështjes së Kosovës sipas vullnetit të popullit shqiptar dhe në bazë të parimit universal të vetëvendosjes së kombeve.

Mid'hat Frashëri insistoi që çështja e Kosovës detyrimisht të trajtohej e të përcaktohej në këtë kuvend dhe të luftohej për zgjidhjen e saj të drejtë pas luftës, sepse, nëse nuk do të ndodhte kështu, atëherë, as që do të përmendej më çështja kosovare dhe Kosova do të ishte e humbur. Ai parashitroi që zgjidhja e statusit të saj të bëhej mbi të drejtën kombëtare të Shqipërisë etnike dhe mbi parimin e vetëvendosjes së kombeve, të garantuar nga Karta e Atlantikut. Ky formullim respektojte vullnetin e popullit shqiptar për vetëvendosje dhe përjashtonte ndryshimin e kufijve me dhunë. Ky formulim harmonizohej edhe me politikën e Fushatës së Mëdha Antifashiste që kishin shpallur botërisht se nuk njihnin kufijtë e ndryshuar me dhunë nga pushtuesit nazifashistë, pra ishte njëherësh edhe një pohim edhe një bashkërrështrim në Frontin Antifashist Ndërkombëtar.

Një rol të rëndësishëm në arritjen e konsensusit luajtën sidomos Mid'hat Frashëri, Ymer Dishnica, Omer Nishani, Abaz Kupi, Hasan Dosti, Isuf Luzzaj, Rauf Fratari, Mustafa Gjinishi, Hysni Lepenica, Nexhat Peshkëpia e të tjerë. Vendimet e Konferencës së Mukjes ishin të qenësishme, jo vetëm për momentin historik, por edhe për ardhmërinë e Shqipërisë e të kombit shqiptar, sepse ato konfirmimin bashkimin dhe jo ndarjen, siguronin luftë të përbashkët kundër okupatorit, për një Shqipëri të lirë e të pavarur, mundësonin në të ardhmen një Shqipëri demokratike dhe rreshtimin përbi Aletëve të mëdhenj Antifashistë, por edhe përcaktimin rrugën më të drejtë për zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare.

Ky program i përbashkët u arrit, pasi të dyja përfaqësitë u treguan tolerante dhe i bënë lëshime njëra tjetrës.

Në këtë pikë, Mukja është edhe shembull i mendimit e i veprimit demokratik si pjesëmarrje, bisedim konstruktiv e tolerancë të admirueshme, një kompromis e një zotim i përbashkët. Është një model i dialogut kombëtar, i debatit dhe i mirëkuptimit. Aleanca që u arrit në Mukje, premtojte se edhe në të ardhmen forcat politike shqiptare do të merreshin vesh midis tyre për çështjet themelore.

Menjëherë pas Konferencës së Mukjes, Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë, organizoi në datën 4 dhe 5 gusht 1943 një betejë të përbashkët në afërsi të Qafë-Shtamës kundër ushtrisë italiane, që marshonte për në Mat.

PROKLAMATË

"Çetat vullnetare partizane të Ushtrisë NÇ dhe çetat e Ballit Kombëtar nën komandën e majorit Abaz Kupi më datën 4 të gushtit 1943, në orën 10.00, mbasi muarën, vesh se ushtria italiane shkonte për në Mat, u nisën për t'i prerë rrugën në të gdhirë. Kur çetat mbërritën në këtë vend, ushtria armike, mbasi dogji disa shtëpi që ndodheshin afër rrugës si dhe komunën dhe zyrën e botores, kaloi dhe po i afrohej Qafë-Shtamës. Mbasi çetat nuk mund të arrinin në kohë, në ato pozita ku do t'i pritnin, u detyruan të ecnin gjithë natën dhe si kaluan malin e Liqenit, i dolën përpara në kufirin e Matit, dy km afër Qafë-Shtamës.

Plot në orën 7.10 të ditës së nesërme, ushtria italiane e përbërë prej 750 vetave, mbërriti në vendin e pritjes e përnjëherësh filloi luftimin, i cili zgjati 3 orë rresht dhe mbaroi me shpartallimin e plotë të ushtrisë armike. Humbjet e armikut janë: 150 të vrarë, 40 të plagosur; 7 robër. Në mes të të vrarëve italianë është dhe oficeri kolonel A.P.Scarpa, të cilit i është gjetur në xhup një medalje të fituar kur ka hyrë në tokën shqiptare ditën e 7 prillit 1939. Është kapur një material kolosal. Të numëruar deri tani janë: një mortajë e rëndë me gjithë municione, 6 mitraloza të rëndë komplekt me municione, 10 mitraloza të lehtë dhe një mijë municione për to, 160 armik lufte, 7 radio fushore marrëdhënëse, 5 kuaj. Gjithashtu janë marrë revolvër, material sanitar, ba-

tanije e materiale të tjera të ndryshme. Humbjet tona janë një i vrarë dhe dy të plagosur."

Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë (AQSH, f.270, d.5, v.1943)

Kjo luftë, dy ditë pas Mbledhjes së Mukjes tregoi se kjo nuk ishte një shprehje historike, por një realitet, nuk ishte vetëm një marrëveshje në letër, por edhe një marrëveshje konkrete për bashkëpunim në luftë, nuk ishte një tradhti që, sipas E.Hoxhës - binte ndesh me interesat e Luftës antifashiste, "por ishte një lidhje bese në dobi të luftës çlirimtare dhe të çështjes kombëtare, nuk ishte një gjë "formale" e një grackë" - siç thoshte E.Hoxha, po një vendim e një veprim i vullnetit të një populli; ishte, në fund të fundit, një ndërgjegje e kthyer në lëvizje e forcave partizane dhe atyre nacionale, që luftuan së bashku si shqiptarë e si vëllezër kundër okupatorëve, nën drejtimin e Komitetit Provizor për Shpëtimin e Shqipërisë. Enver Hoxha, nën presionin e emisarëve të PKJ në Shqipëri, prishi dhe shkeli në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare Marrëveshjen e Mukjes. Marrëveshja e Mukjes prekte sidomos interesat dhe synimet e qarqeve shoviniste serbomëdha që sundonin në PKJ, të cilat kërkonin përjetësimin e pushtimit serb të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare, si edhe nënshtrimin e plotë të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë. Prandaj edhe prishja e njëanshme e Marrëveshjes së Mukjes ishte kryesisht rezultat i ndërhyrjes jugosllave, të cilës nuk i interesonte kursesi marrja dhe plotësimi i atyre vendimeve. Reagimi i shpejtë e i vendosur i kolonit malazes në Kosovë, M.Popoviçit, ishte i kuptueshëm. Kur aktet e marrëveshjes së Mukjes iu dorëzuan "mentarit" të Enverit, ai i tërbuar i grisi ato, i bëri copë-copë dhe ia hodhi në surrat Enver Hoxhës. Kjo ndërhyrje brutale e Partisë Komuniste Jugosllave në punët tona të brendshme vërtetohet edhe nga një letër që udhëhoqësi real i PKSH, M.Popoviçit, i dërgoi Titos: "Kemi ndikuar në PKSH dhe në LNCL që gjithsesi të prishim Marrëveshjen e Mukjes".

"Traktati i Konferencës së Mukjes shkaktoi një turbullim të madhe, - shkruante Dushan Mugosha. - Organizata e Partisë në Vlorë, nën drejtimin time, shkroi traktatin dhe ua drejtoi të gjitha njëse të Ballit Kombëtar ku thuhej shkurt e qartë: kush nuk dëshiron me ne, është kundër nesh... Bash në këtë situatë, pa pritë, vjen Trakti nga Konferenca e Mukjes me nënshkrimin e Y.Dishnicës... Asht e nevojshme me pyet KQ se mos rastësisht Proklamata e Konferencës në Mukje asht falsifikim".

E.Hoxha, nën diktatin e M.Popoviçit dhe Dushan Mugoshes, me të cilët ishte në Vithkuq, pa përfillur Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, i cili kishte nënshkruar me B.Kombëtar Marrëveshjen e Mukjes, pra, pa mbledhur dhe pa marrë mendimin e Këshillit të Përgjithshëm NCL, më datën 8 gusht 1943, si një partiak u dërgoi një letër -qarkore shokëve të partisë së Vlorës, Gjirokastërës etj: "Lajmëroheni se ju është dërguar nga Tirana një trakt për t'u shpërndarë, i firmosur prej Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, ku flitet për bashkimin e plotë të arritur në mes të KNCL dhe Ballit Kombëtar. Ky trakt është në kundërshtim me vijën nacionalçlirimtare dhe disaprovet nga KQ i Partisë. Prandaj, në rast se nuk i keni shpërndarë, çirini dhe të mos flitet më për të". Shkak tjetër kryesor për prishjen e njëanshme të Marrëveshjes së Mukjes ishte çështja e pushtetit. Synimi i pushtetit është një akt normal në çdo kohë, por vendimi i PKSH për ta marrë pushtetin me dhunë e me gjak, duke shkelur edhe vendimin e Mukjes se çështja e pushtetit do të zgjidhej pas luftës me zgjedhje demokratike. Kjo sollë edhe luftën civile në Shqipëri, pasojë më tragjike e prishjes së Marrëveshjes së Mukjes. Udhëhoqësia doktrinator e PKSH, dënoi Marrëveshjen e Mukjes në Konferencën e dytë të Labinotit, 4-9 shtator 1943, ku përveç M.Popoviçit dhe D. Mugoshës, merre pjesë edhe Billazho Jovanoviç, i dërguar i posaçëm i PKJ, i cili luajti një rol madh si i dërguari i Titos në konferencë, për të hedhur poshtë marrëveshjen e Mukjes, për të dënuar protagonistët e saj, por edhe për të marrë vendimin e mësymjes ushtarake mbi Ballin Kombëtar dhe nacionalistët e tjerë antifashistë, si Muhareme Bajraktari, Gani Kryeziu etj. Konferenca e Labinotit dënoi për tradhti delegatët e saj në Kuvendin e Mukjes, edhe pse i kishte autorizuar për marrëveshje. Mustafa Gjinishi u dënua me vdekje dhe u vra në vitin 1944 në një pritë të organizuar nga E.Hoxha, Ymer Dishnica, një nga protagonistët e shuar të Marrëveshjes së Mukjes, u dënua me burg dhe mandej me internim, po ashtu edhe disa nga delegatët e tjerë të Nacionalçlirimtarës. Gjithashtu i quajti tradhtarë e kolaboracionistë delegatët e Ballit Kombëtar; me të cilët lidhi marrëveshje bashkëpunimi pak ditë më parë. Madje, nisi guetinë e shtrigave për asgjësimin e tyre.

Pasojat e prishjes së Marrëveshjes së Mukjes dhe të Luftës Civile vazhduan për gjysmë shekulli komunizëm, por ndjehen edhe sot, në ndarjen dhe politikën e sotme konfliktuale, në urrejtjen dhe armiqësinë, mungesën e kompromisit e të bashkëpunimit për interesat e popullit dhe ato kombëtare. Mukja është një çështje kyç në historinë moderne, por dhe një çelës për të hyrë brenda saj, për të ndriçuar e shpjeguar fenomenet e ngjarjet më të rëndësishme të Luftës së Dytë Botërore dhe të gjithë periudhës gjysmëshekullore që pasoi, është një mësim për të gjithë ata që duan të mësojnë nga historia, një mesazh i nevojshëm për sot dhe për të ardhmen.

HOROSKOPI

DASHI

Sot do të keni një të shpenzimeve familjare gjë të cilën nuk mund ta shmangni. Do të merrni disa vendime të rëndësishme sa u përket investimeve. Do të kaloni një ditë shumë të këndshme me familjarët dhe do të përmirësoni marrëdhëniet me disa nga miqtë tuaj. Partneri/partnerja juaj do t'ju dedikojë disa falë me shumë vlerë sot.

DEMI

Duhet të merrni disa ditë pushim, pasi keni nevojë të fitoni energjitë e humbura dhe të ndiheni në formë. Dëgjoni këshillat e të afërmit tuaj nëse do të merrni një vendim të rëndësishëm. Mos ua impononi mendimin tuaj të tjerëve, pasi kjo do t'ju shkaktojë vetëm probleme. Partneri/partnerja juaj nuk do t'ju mbështesë shumë sot në disa situata të vështira.

BINJAKET

Sot ka gjasa të përbaleni me disa probleme ligjore. Nëse keni në plan të investoni diku, duhet të tregoheni shumë të kujdesshëm, në mënyrë që të shmangni humbjet. Përpikuni të mos tregoheni imponues në marrëdhënie tuaj në çft. Për të marruarit do të jetë një ditë shumë e vështirë.

GAFORJA

Kaloni me shumë kohë me fëmijët, pasi do të gërohni nga stresi. Do të keni të ardhura të mira gjatë ditë së sotme. Mbari distancë ndaj disa personave që sapo keni njohur dhe që përipien të bëhen miq menjëherë me ju. Dikush mund t'ju kopimentojë sot. Mund të dashuroheni sërish me partnerin/partren tuaj, pasi e meritoni.

LUANI

Sot do të përbaleni me një situatë të vështirë, por një miq juaj do t'ju ndihmojë ta përballoni. Dëgjoni sa më shumë muzikë që të largoni tensionin. Shmangni shpenzimet e tepërta dhe përipiuni të kurseni sa më shumë. Partneri/partnerja juaj do të bëjë një veprim, që fillimisht nuk do t'ju pëlqejë, por më pas do të zbuloni se ka pasur qëllim të mirë.

VIRGJERESHA

Është koha e duhur për t'u çliruar nga frika. Ka gjasa që sot të haseni me një konflikt. Përpikuni të silleni me qetësi. Zgjidhni fjalët kur të bashkëbisedoni me disa persona të caktuar. Sot do të kuptoni se çfarë do të thotë të kesh një partner/partnere të mirëkullueshme.

PESHORJA

Shëndeti do t'ju bëhet pengesë për disa aktivitete gjatë ditës. Përmirësimi i gjendjes financiare do t'ju bënë të bënë disa blerje të rëndësishme. Organizoni një mbërrimje me miqtë, pasi do t'ju bëjë të ndiheni shumë mirë. Përpikuni të tregoheni shumë të kujdesshëm me sjelljen tuaj, sepse partneri/partnerja juaj nuk do të ketë humorin e duhur.

AKREPI

Shmangni stresin dhe tensionin, pasi do t'ju ndikojë në shëndet. Përdorni ide të reja për të fituar më shumë para. Partneri/partnerja do të mendojë për ju gjatë gjithë ditës dhe do të kaloni momente shumë të këndshme romantike.

SHIGJETARI

Sot do të ndiheni plot energji dhe përpikuni ta shfrytëzoni atë për të përfunduar disa detyra. Të afërmit mund t'ju shkaktojnë tension. Ruani qetësinë dhe mbani situatën në kontroll. Çdo vendim i gabuar do t'ju kushtojë shumë. Sot nuk do të jetë dita juaj sa i përket marrëdhënies në çft.

BRICJAPI

Dini shtëpitë, pasi do t'ju ndikojë mirë në shëndetin tuaj. Miqtë dhe të afërmit do të kërkojnë më shumë kohë për të qëndruar bashkë, por nuk është momenti i duhur, pasi duhet t'ju kushtoni më shumë kohë vetes. Mos u dorëzoni para kërkesave të partnerit/partnereve tuaj.

UJORI

Merziza do të jetë shikaku i problemeve shëndetësore. Nuk është dita e duhur për të bërë investime. Detyrimet familjare kërkojnë vëmendje të menjëhershme. Neglizhenca nga ana juaj do t'ju kushtojë shumë. Sa i përket marrëdhënies në çft, do të përbaleni me disa probleme të vogla.

PESHQIT

Sot do të ndiheni shumë mirë. Vitoni çdo gjë që mund të ndikojë negativisht te ju. Mos merrni vendime të rëndësishme sa i përket shpenzimit të parave. Planet do të ndryshojnë krejtësisht për shkak të përpjekjeve për të zgjidhur disa probleme. Përpikuni të ruani qetësinë, sepse mund të grindeni me partnerin/partren tuaj.

Dje/në 'Deutsche Welle'

Turqia dhe Evropa, në kërkim të përbashkësive

Nga Kersten Knipp

(vijon nga faqja 1)

...të mëdha mund të zgjidhen vetëm me përpjekje ndërkombe. Rreth katër milionë njerëz nga Siria ka pranuar Turqia aktualisht, marrëveshja e BE me Turqinë luan në këtë kuadër një rol të madh. Që prej shkurtit 2016 sirianëve u lejohej të punojnë në Turqi. Kjo ka bërë që shumë prej punëve të thjeshta, me paga të ulëta që kryheshin më parë nga vendësit, tani bëhen nga sirianët. Refugjatët bënë edhe që qirat të rriten, para së gjithash në lindje të Turqisë. Nga ana tjetër, refugjatët sirianë në bazë të të dhënave zyrtare kanë investuar tashmë mbi 330 milionë dollarë në ekonominë turke - për shembull për të ngritur sipërmarrjet e tyre. 6000 të tilla ekzistojnë tashmë. Megjithatë, refugjatët nuk kanë mundur ta bëjnë deri tani për vete Turqinë. "A është vendi ynë kuzhinë popullore? Vendi im është plot të papunë", tha në fushatën elektorale për zgjedhjet presidenciale në Turqi sfiduesi i Erdoganit, Muharrem Ince nga Partia Popullore Republikane (CHP). Kundër Erdoganit, ai nuk pati shans, por arriti në vendin e dytë me 30 për qind të votave, edhe në sajë të kritikës për politikën e refugjatëve të Erdoganit. Shprehje kritike të tilla dëgohen me dëshirë nga një pjesë e popullit, në një kohë kur ekonomia turke po tregon shenja dobësie në shumë aspekte.

ERDOGANI NËN PRESION

Në përputhje me këtë Erdoganit është nën presion edhe pas zgjedhjeve. Prandaj ai përpigjet që me ndihmën e ushtrisë dhe të milicëve sirianë të paguar t'i vendosë nën kontrollin e tij pjesë të Sirisë Veriore, - thotë Günter Meyer, drejtes i Qendrës për Studimin e Botës Arabe në Universitetin e Mainzit. "Kjo do të ishte një



zonë që në këndvështrimin e Erdoganit është e përshtatshme për të lehtësuar kthimin e sirianëve nga Turqia". Për Evropën, për Gjermaninë, interesi i Erdoganit ofron shanse dhe vështirësi njëkohësisht. Kështu me sa duket Erdoganit është mirënjohës për çdo refugjat sirian që largohet sërish nga Turqia, pavarësisht se në cilin

drejtim. Në këtë kuadër, numri i refugjatëve që mbërrijnë nga Turqia në Greqi që prej fillimit të majit është nëntëfishuar, më shumë se 15000 veta e kaluan Mesdheun midis Turqisë dhe Greqisë. Prandaj komisar i BE për Migrimin dhe Punët e Brendshme, Dimitris Avramopoulos, kërkoi që të rritet prania e rojes kufitare dhe breg-

detare prej 1500 vetash të BE. Njëkohësisht ai tha se marrëveshja për refugjatët midis BE dhe Turqisë vazhdon të funksionojë.

TURQISË I DUHET STABILITET NË SIRI

BE dhe njëkohësisht Gjermania përfitojnë nga interesi i Erdoganit për të kontribuar sa më shumë

që të jetë e mundur për paqëtimin e shtetit fqinj. "Turqia është shumë e varur nga stabiliteti në shtetin fqinj", thotë Günter Meyer. Ky është edhe interesi i Gjermanisë - një pikë tjetër lidhëse, po ta vizitojë Erdoganin në vjeshtë Gjermaninë. Turqia ka ftuar në fillim të shtatorit edhe për t'u konsultuar për zhvillimet në Siri në një bisedë katërshe Rusinë, Francën dhe Gjermaninë. Vërtet që ende nuk ka reagime nga këto vende, por të gjithë janë të interesuar për fundin e luftës në Siri dhe për kthimin e refugjatëve në atdheun e tyre.

SHENJA AFRIMI NGA GJERMANIA

Edhe Gjermania sinjalizon vullnet për një afrim të ri. Kështu, një pjesë të sanksioneve ndaj Turqisë qeveria gjermane nuk i zgjati. Sipas mediave, kufiri i sipërm i garantimit të eksporteve në Turqi nga qeveria gjermane, i vendosur më 2017 si mjet presioni ndaj Turqisë, këtë vit nuk u zgjat - dhe kjo pavarësisht faktit se situata e të drejtave të njeriut në Turqi nuk është përmirësuar dhe në burgjet e Turqisë ndodhen edhe më tej 46 nënshtetas gjermanë. Ministria e Jashtme i zbuloi pas fundit të gjendjes së jashtëzakonshme në Turqi edhe këshillat për udhëtimin për turistët dhe biznesmenët. Nga kjo përfiton veçanërisht industria turke e turizmit. Ajo e ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme një zbutje të tillë. Jo vetëm Gjermania, edhe Holanda kërkon që pas fundit të gjendjes së jashtëzakonshme, t'i vërë marrëdhëniet me Turqinë në baza më të mira. "Një normalizim i plotë i marrëdhënieve turko-evropiane megjithatë nuk është i afërt, sepse vazhdojnë të ekzistojnë shumë dallime politike edhe pas heqjes së gjendjes së jashtëzakonshme", thotë Günter Seifert nga "Fondacioni Shkenca dhe Politika".


BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Fjalëkryqi (1)



- 38. Nuk ka akoma një bebe.
- 39. Fillojnë mirë.
- 40. Janë brinjë në skuadër.
- 42. Shkruhet i shtati.
- 44. Nget edhe ajo e mirë
- 47. Mbahet në gisht.
- 48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

- 1. Kanë shpatë të tilla.
- 2. Janë edhe ato polare.
- 3. Janë mizorët.
- 4. Janë male në Rusi të tilla
- 5. Eshhtë nusja me vello.
- 6. Një rreth pa ekstreme.
- 7. Mbyllin kuvendin.
- 8. Në kryt të titujve
- 9. Diku në qendër.
- 10. Markë cigaresh.
- 13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
- 14. Janë penjtë për gjerëqef.

HORIZONTAL

- 1. Eshhtë babëzia.
- 8. Burton regjisor.
- 11. Skllavja e Abrahamit.
- 12. Një ditë në mbledhje.
- 14. Tyson i boksit.
- 15. Rrethojnë ringun.
- 17. Beson pa kufij.
- 19. Zola që shkroi Nana.
- 20. Eshhtë ankimum.
- 23. Pak elementarë
- 24. Janë me para në bankë.
- 26. Matet pa kufij.
- 27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
- 28. Një zog i verdhë.
- 29. Inicialet e Moravia-s.
- 31. Qytet gjerman.
- 34. Një zonjë që ha gurë.
- 35. Pak analogji.
- 36. I ka plasur të paturpit.
- 37. Janë legjendat.

- 16. Mbarojnë fare.
- 18. Janë stitët e... provimeve.
- 20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
- 21. Vitet pa kufij.
- 22. Një fjalë për tutje.
- 24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- 25. Eshhtë e akuzuara... injorante
- 26. Baldwin aktor
- 28. Krenar pa çift.
- 30. Grazia Cucinotta.
- 32. Paul këngëtar.
- 33. Janë pëshqjellat.
- 35. Inicialet e Moravia-s.
- 37. Pak makinacione.
- 38. Samuel bomber kamerunas.
- 40. Markë makine koreane.
- 41. Ente Kombëtare Durrës.
- 42. Fillojnë kurat.
- 43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
- 45. Ekstreme në litar.
- 46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Satelit i Uranit.
- 6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
- 11. Tiran pa kufij
- 12. Në krye të armatës.
- 13. Një Ibrahim violinist.
- 14. Qendër ditore.
- 15. Mund të jenë fotografikë.
- 17. Inicialet e Einstein.
- 18. Një mbishkrim në kryq.
- 20. Janë si vite.
- 21. Thurman aktore.
- 22. Të parat në irritim.
- 23. I preu Seneka.
- 25. Fillojnë ilustrimet
- 26. Isaac Asimov.
- 27. Një Vladimir kompozitor.
- 28. Janë në modë.
- 30. Janë zyrat... qeveritare
- 32. Me të nxjerrin trarë.
- 35. Një shkop, thupër.

VERTIKAL


- 37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
- 39. U thyen në Salamina.
- 40. Një raport shumë i ngushtë.
- 41. Nota e diapzonit.
- 42. Fund heroi.
- 43. Një top në rrjetë.
- 45. Gjysma alarmi.
- 46. Herët pa zë.
- 47. Sampras i tenisit.
- 48. Me të bëjnë triko.
- 49. Një guajitje futurimthi në tenis.
- 50. Janë kokrrat e lisit.

VERTIKAL


- 1. I famshëm ai i Sizifit.
- 2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
- 3. Fillojnë rastësisht.
- 4. Një pjesë e napolitanëve.
- 5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
- 6. Mund të jenë kundërajrore.
- 7. Lindin në kokë.
- 8. Gjysmë shtegu.
- 9. Hidhen të parat.
- 10. Eshhtë njeriu i përsosur.
- 13. Një fjalë për tutje.
- 15. Fundi i një samurai.
- 16. Mbyllim me epilog.
- 17. Bel i maupassant.
- 19. Inicialet e Redford.
- 23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
- 24. Në hyrje të tokës.
- 26. Pak impresioniste.
- 27. Janë metrat në sipërfaqe
- 29. Hapet një për ajër.
- 30. Gjysmë krenar.
- 31. Një hidrokarbur.
- 33. Vrau Hektorin.
- 34. Një film i rixhiruar.
- 36. Kupat pa kufij.
- 38. Inicialet e Nolte aktor.
- 41. Ullmann aktore.
- 43. Një brilantinë moderne
- 44. Hotel pa kufij.
- 46. Ekstreme në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRÇJGJËT E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

C	L	A	U	D	E	K	N	G	O		
S	A	G	A	N	G	A	N	I	M	E	
O											
L	A	R	P	A	G	A	N	I	A		
O	K	E	A	K	L	A	S	I	O	M	A
K	E	F	A	K	U	V	L	I	K	A	
A	R	O	S	A	K	T	E	T	A		
L	O	B	T	N	I	G	O	T	A		
S	T	A	U	I	P	H	E	R	O	I	
P	I	S	T	A	M	O	S	T	I	E	
Y	A	R	D	E	M	E	T	R	A		

FJALËKRYQI (2)

S	A	R	A	B	A	D	P	L	A						
A	D	O	E	S	I	D	E	R	I	U					
T	E	R	A	B	U	R	I	D	A	N	I	A			
A	R	A	B	A	H	A	R	A	K	I	R	I	E		
P	I	T	O	N	I	H	D	A	N	A	L	T			
P	I	T	O	N	I	H	A	S	I	M	U	R	I	A	L
S	U	S	P	A	R	I	D	I	A	L					
S	A	I	F	A	R	I	S	E	J	T	E				
G	J	A	K	U	A	Y	R	E	U						
K	I	N	I	N	A	P	R	O	T	E	U				
K	I	N	T	D	E	D	I	T	H	S	A				

SUDOKU

				6		2	7
5			3	2			9
					6	1	
	7					5	
	6		4		3	2	
9	5	1			8		6
	8	5					
1			3				
				3		5	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	6	1	5	4	2	8	9	3
4	5	8	6	3	9	7	1	2
3	9	2	7	8	1	4	5	6
6	3	5	2	1	7	9	4	8
2	1	4	3	9	8	5	6	7
8	7	9	4	5	6	2	3	1
9	4	7	8	6	3	1	2	5
1	8	3	9	2	5	6	7	4
5	2	6	1	7	4	3	8	9

Argëtim filozofik

- Disa njerëz janë shumë të varfër, gjithçka që ata kanë janë paratë.
- Që ti thuash të vërtetën dikuj që nuk të kupton, ndonjëherë është më keq sesa ta gënjesht.
- Forca e vullnetit është ajo që ju detyron të fitoni, kur logjika juaj thotë se ju keni humbur.
- Një grua e bukur është ferr i shpirtit, pastruese e xhepit, dhe parajsë e syve.
- Një njeri i kompletuar ka qetësi për të pranuar gjërat që nuk mund të ndryshojë, ka fuqi për të ndryshuar gjërat që mundet dhe mençurinë për të kuptuar diferencën.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

1	K	U	L	T	14	4	9	7	4	19		
8	10	5		1	4	12	2	6	7	5	10	
10	2	7		4	1	2	8	10	6	2	7	5
18				1	7	5	8	9	4	2	10	4
6	5	1		6	2	10	5	2	5		12	
7	1			17	5		1	5	10	17	4	2
2	5	10	17	4	2		4	10	6	15	5	
8		2	8	12	15		6	10	17	5		
18	10	5	16	19	6		4	8	10	1		
6	7	5		6	11	5		9	19	6	7	
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6
12	5	2	5		12	1	6	15	4	2		8

K	A	F	E		T	A	L	E	N	T	
A	D	A	M		P	A	F	T	E	R	
T	E	T		H	E	P	A	T	I	T	I
E	T		H	E	R	E	T	I	K	E	
G		K	O	M	I	T	E	T	E	T	
O		E	K	I	P	E	T	T	F		
R	I	K		N	E	T		T	A	P	A
I	O		G	C		S	T	I	L		
K	P		S	W	I	N	G		S	L	
E	O		P	A	T	E	N	T	A	T	
N	A		Y	E		U	R	A	T		
T	Y	M	I		P	I	R	A	T	I	

Thënie të mençura

- Mos kini frikë, kur ju eci ngadalë. Kini frikë vetëm kur ju qëndroni
- Kur ligji dhe morali përplasen me njëri-tjetrin, qytetari ka zgjedhjen të humbi perceptimin e moralit apo të humbi respektin e tij për ligjet..
- Një vendim i vogël ka nevojë për logjikë. Një vendim i madh ka nevojë për instinkt.
- Asnjëherë mos i justifikoni veprimet tuaja. Miqtë tuaj nuk kanë nevojë për këtë, dhe armiqit tuaj nuk do të ju besojnë gjithsesi.

